

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ





# HULUMTIM RRETH DURIMIT

**Imam Sejid Ali Khamenei** (*Allahu e mëshiroftë!*)

**Tiranë, 2026**

Titulli: **Hulumtim rreth durimit**

Autori: **Imam Sejid Ali Khamenei (Allahu e mëshiroftë!)**

E përktheu nga arabishtja: **Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

E redaktoi: **Prof. Hajri Shehu**

E korrektoi: **Ma. Isra MERJA**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie FEZA**

Kopertina: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata “Flladi” - Tiranë, 2026**

بسم الله الرحمن الرحيم

**Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit!**

## **Parathënie**

Ja ku është pasardhësi i Familjes së pastër (Ehli Bejtit) dhe trashëgimtari i Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Imamëve (Paqja e qoftë mbi ta!), duke mbajtur flamurin e xhihadit në rrugën e Allahut dhe për lartësimin e Fjalës së Allahut. Ai fryn te shpirtrat e besimtarëve forcën e qëndresës dhe të palëkundshmërisë në rrugën e përballjes me vështirësitë.

Ja ku është pasuesi i imam Khomeinit, ringjallësit të Islamit, që ngre lart flamurin e përballjes së pareshtur kundër tiranëve dhe keqbërësve. Në dorën e tij është feneri i udhëzimit, që u tregon masave të etura për liri rrugën për të ecur përpara. Ja ku është Juristi i vërtetë, që është shkrirë me Islamin e vërtetë autentik muhamedan, që e ka njohur rrugën e tij të drejtë dhe fton drejt saj me vetëdije të plotë atë dhe ata që e ndjekin. Ai i nxit dashamirët e së Vërtetës dhe të dinjitetit që të ecin përpara deri në përmbushjen e synimeve të mëdha të Allahut.

Myslimanëve u kishte munguar për qindra vjet një dritë dhe një fener i tillë udhëzimi, mu në periudhat më të

errëta të historisë së tyre, atëherë kur kishin nevojën më të madhe për të, e kur armiqtë i sulmonin nga çdo anë.

Myslmanëve u kishte munguar udhëheqësi i vërtetë, i cili beson në Allahun dhe në Islamin si fe gjithëpërfshirëse dhe si zgjidhje e plotë. Myslmanëve u kishte munguar udhëheqësi që e njih rrugën e Islamit, jo vetëm me dijet e tij, por edhe që beson te populli e ymeti, duke treguar dhembshuri dhe kujdes për ta. Dhe në errësirën e humbjes dhe të hutimit, u shfaq ylli i imam Khomeinit (Allahu e mëshiroftë!), duke ringjallur në ymet një shpresë të re dhe një shpirt të fuqishëm. Ai e çliroi ymetin nga fryma e nënshtrimit dhe e poshtërimit, dhe i pruri dinjitetin dhe krenarinë. Dhe për herë të parë, pas shumë shekujsh, umeti e kuptoi domethënien e Islamit të vërtetë...

Imam Khomeini e paraqiti Islamin me mësimet dhe shpirtin e tij, pa i ndarë kurrë këto dy dimensione. Kjo frymë e mbushur me origjinalitet dhe autenticitet u fut në trupin e sëmurë të ymetit, dhe i dha atij jetë, forcë, vendosmëri dhe zell për përparim.

Islami pa xhihad dhe pa përballje me padrejtësinë është si një trup pa shpirt dhe si një formë pa zemër. Xhihad do të thotë përpjekje e plotë për vendosjen e sundimit të Allahut mbi tokë. Kjo është shfaqja e vërtetë dhe e plotë e adhurimit të singertë të Allahut të Madhëruar, si dhe përballje me tiraninë dhe format e saj të shkatërrimit, krimit dhe shthurjes. Allahu i Madhëruar thotë:

{فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنِ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى}

**“Kush mohon tagutin dhe beson në Allahun, është kapur fort pas lidhjes më të sigurt.”<sup>1</sup>**

Kur shumë dijetarë shtrinë një litar, që mëtonin se ishte Islami, imam Khomeini shtriu një litar të fortë e të sigurt (*el-urvetu'l-vuthka*). Kështu na u shfaq ai shpirt i pastër dhe i ëmbël i fesë së vërtetë të Allahut.

Si mund të besojë me të vërtetë në Allahun ai që nuk e mohon tagutin?! Si mund të ngjitet në miraxhin e namazit ai që nuk merr abdes për martirizim në rrugë e luftës kundër tagutit?! Si mund ta arrijë njeriu mirësinë e besimit, ndërkohë që sheh vejushat, të torturuarit dhe të shtypurit duke rënkuar nën kamxhikët e padrejtësisë dhe të tiranisë së tagutëve?! A mund ta shijojë njeriu ëmbëlsinë e besimit të singertë, kur nuk mban përgjegjësi për shoqërinë? A mund të quhet mysliman ai që dëgjon thirrësin që thotë: “O myslimanë!”, dhe nuk i përgjigjet? Ku ka Islam që pranon poshtërimin për pasuesit e tij, ndërkohë që Allahu thotë:

{وَلِلَّهِ الْعِزَّةُ وَلِرَسُولِهِ وَلِلْمُؤْمِنِينَ}

**“Lavdia u takon Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve.”<sup>2</sup>**

<sup>1</sup> Sure “El-Bekare”, ajeti 256.

<sup>2</sup> Sure “El-Munafikun”, ajeti 8.

Çfarë Islami është ai që pranon që pasuesit e tij të jenë si bagëtitë, të mos e kuptojnë domethënien e dinjitetit, të parapëlqejnë jetën e kësaj bote para Ahiretit, materialen para shpirtit dhe e pshet para vlerave fisnike?!

Po, ky është “Islami amerikan”, të cilin Amerika e ka prodhuar dhe e ka paraqitur përmes qindra mjeteve dhe propagandave, pas të cilit rendin shumë zëra në Lindje e Perëndim e në vende të ndryshme, sepse duan ta shkatërrojnë Islamin në emër të Islamit.

Dhe në këtë betejë të madhe e në këtë përplasje të ashpër, qëndron një Sejid nga pasardhësit e Aliut dhe Husejnit, për të thënë: Jo tagutit, jo poshtërimit! Ai mban flamurin e xhihadit dhe shpall se nuk do të lejojë që të shuhet flaka që e ndezi Imami. Kur e sheh dhe dëgjon fjalët e tij, të duket sikur Bedri, Hajberi, Siffini dhe Ashuraja kanë ndodhur dje. Kështu e lexon historinë në librin e përballjes dhe të rezistencës. Dhe historia e vërtetë është pikërisht kjo.

Sa shumë kemi nevojë për këtë busull që na tregon drejtimin e saktë, në një kohë kur shumëkush mendon se shpirti i Islamit është shuar në zemrat e myslimanëve.

Sa shumë kemi nevojë për dikë që të na kujtojë përgjegjësinë tonë, të cilën nëse nuk e përmbushim, do të na kaplojë poshtërimi, turpi dhe nënçmimi.

Sa shumë kemi nevojë për atë që rrënjës në damarët tanë forcën e durimit dhe të përballimit, që të vazhdojmë rrugëtimin tonë.

Ky libër që po ta paraqesim ty, lexues i nderuar, është fryt nga frytet e atij xihadi të vështirë dhe të gjatë që e zhvilloi Hirësia e Tij, Imam Khamenei (Allahu e mëshiroftë!) për shumë vjet me radhë, pa u lodhur e pa u mërzhitur. Ai lëvizi nga një shtëpi në tjetrën dhe nga një burg në tjetrin, ndërsa shihte një ymet të habitur dhe të tronditur nga goditjet e keqbërësve; një umet të dëshpëruar dhe të demoralizuar, tek i cili konceptet islame që frymëzojnë krenari, dinjitet dhe liri qenë shndërruar në koncepte që nxisin plogështi, nënshtrim dhe poshtërim.

Sa e vështirë qe kjo detyrë! Si mund të zgjohet një popull që vulën e poshtërimit e ka mbajtur në historinë e tij për qindra vjet? Si mund të nxirret nga errësirat e humbjes ai që nuk ka parë dritë për shekuj me radhë?

Kushdo që mendon për madhështinë e kësaj detyre dhe peshën e kësaj përgjegjësie, e kupton se ajo është për një njeri që duhet të dallohet për cilësi të jashtëzakonshme: cilësi që depërtojnë në thellësitë e historisë, që marrin dritë nga burimi i pastër i fesë dhe që e njohin kohën dhe realitetin e tyre të plotë, në mënyrë që të përcaktojnë rrugën e shpëtimit për të ardhmen. Këto cilësi të larta dhe madhështore janë ato që janë bashkuar në personalitetin e Imamit tonë udhëheqës (Allahu e mëshiroftë!), duke e bërë

atë një prijës që na rikthen në kujtesë figurat e mëdha të udhëheqësve të caktuar nga Zoti. Ah, sikur të kisha mundësi t'i përshkruaja këto cilësi! Por si mund ta shohë dritën e diellit një lakuriq nate?! Dhe si mund të mbajë një milingonë një mal?!

Të ftoj ty, o lexues i nderuar, që të lexosh gjithçka që ka thënë dhe ka shkruar ky Imam dhe Fakijh dhe të meditosh me kujdes për dimensionet e fjalëve të tij. Nëse e bën këtë, me lejen e Allahut, do të shohësh një pamje që do të mbushë zemrën tënde me gëzim dhe kënaqësi të pashoqe. Është gëzimi që vjen nga njohja dhe vështrimi i miqve të veçantë të Allahut.

Në këtë libër, i cili është një artikull i gjatë e një studim gjithëpërfshirës për durimin (*sabrin*), shohim qartë se Hirësia e Tij, Imam Khamenei (Allahu e mëshiroftë!), e trajton këtë koncept themelor të Islamit nga të gjitha dimensionet e tij. Ai e nxjerr atë nga suaza e ngushtë individuale në mendjet e njerëzve dhe e shtrin në horizontet e gjera shoqërore.

Kjo qasje është një model i mendimit të këtij personaliteti të madh. Sepse Islami, në realitetin e tij të vërtetë, nuk ka qenë kurrë vetëm fe e adhurimeve dhe e çështjeve personale të individit. Që nga lindja e tij e parë, ai e ka trajtuar çështjen e shoqërisë në një shkallë të gjerë dhe në aspektet më të thella të saj. Ai ua ka ngarkuar pasuesve të vet përgjegjësinë për të ngritur një sistem qeverisjeje mbi

bazën e parimeve dhe mësimave të Allahut, dhe i ka bërë çështjet e ymetit, të botës islame çështje të lidhura ngushtë me vetë thelbin e besimit dhe të Islamit. Kështu ka qenë Islami dhe kështu do të mbetet flaka e tij e ndezur, për sa kohë që do të ketë udhëheqës të mëdhenj si ky.

**Kum i Shenjtë**

**21 Sheval 1420 Hixhri/28 Janar 2000.**

## Koncepti i durimit

Durimi (*sabri*) është një nga konceptet islame më të qarta dhe më madhështore. Ai është përdorur në tekstet islame në shumë raste dhe është trajtuar me stile e mënyra të ndryshme, në përputhje me temat ku përmendet, duke e shoqëruar me përshkrime për sevapin e shpërblimet e tij. Në hadithe dhe transmetime të tjera islame, jepet që të zgjojë në shpirtin e myslimanit dëshirën për ta njohur më mirë këtë virtyt dhe për t'u stolisur me të.

Fatkeqësisht, ky koncept, ashtu si shumë koncepte të tjera islame, është ekspozuar me shtrembërime që ka goditur shumicën e koncepteve islame. Kuptimi i tij është shtrembëruar deri në atë masë, sa është përmbysur krejtësisht.

## Koncepti popullor për durimir

Zakonisht, durimi përkufizohet si përballim i dhembjeve dhe hidhërimeve. Ky përkufizim dhe ky koncept shoqërohen me paqartësi dhe mjegullim të madh, aq sa i lejojnë kujtdo ta interpretojë sipas kuptimeve të ndryshme, madje edhe të kundërta. Mirëpo, nëse koncepti i

durimit paraqitet në mënyrë të gabuar në një shoqëri, që jeton nën padrejtësi dhe shtypje, dhe që është e nënshtruar ndaj formave të ndryshme të shkatërrimit dhe të degjenerimit, ai shndërrohet në një mjet të rëndësishëm për keqbërësit dhe të korruptuarit për ta vazhduar sundimin dhe shtypjen e tyre. Ai bëhet një faktor që ndihmon prapambetjen, pasivitetin, korrupsionin e rënien morale. Kur një populli që vuan nga varfëria, privimi dhe prapambetja i thuhet “Duhet të bësh durim”. Gjëja e parë që ai kupton nga kjo këshillë, si një veprim praktik, është se duhet të përballojë hidhërimet, vuajtjet dhe kushtet e ashpra e shkatërruese që i imponohen. Për pasojë, kjo shoqëri, jo vetëm që nuk do të lëvizë drejt ndryshimit dhe revoltës kundër gjendjes së keqe, për t’u çliruar nga errësira dhe humbja, por do të mashtrojë veten duke menduar se për këtë “durim” po fiton shpërblim dhe sevap tek Allahu. Dhe tërhiqet në vetvete, bëhet indiferente ndaj asaj që ndodh, nuk shqetësohet për atë që e rrethon, jeton me kënaqësi të rreme dhe mendon se kjo është një fitore e madhe për të. Është e qartë se përhapja e një fryme të tillë në shoqëri u sjell përfitime të mëdha klasave sunduese dhe shtypëse, të cilat dëshirojnë të ruajnë privilegjet e tyre. Ndërsa dëmin e paguajnë shtresat e dobëta dhe të shtypura.

Fatkeqësisht, ky kuptim i gabuar, me të gjitha pasojat dhe ndikimet që sjell, mbizotëron sot në shumë shoqëri islame. Madje, paraqitja e çdo kuptimi tjetër për durimin, edhe nëse është i pranueshëm dhe logjik, kërkon shumë

argumente dhe sqarime për ata që nuk i kanë njohur siç duhet mësimet dhe dijet islame. Shpeshherë, diskutimi me ta në këtë drejtim mund të mos japë rezultat. Dhe po t'i shqyrtojmë ajetet kur'anore dhe hadithet që e trajtojnë konceptin e durimit në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse, do të habitemi kur të shohim se deri në çfarë shkalle të rrezikshme ka arritur ky shtrembërim i kuptimit të tij.

## **Një vështrim i përgjithshëm për burimet që trajtojnë durimin**

Nëse e kuptojmë domethënien e durimit (*es-sabr*), ashtu siç është paraqitur qartë në ajetet e Kur'anit dhe në transmetimet e Profetit dhe të Imamëve (Paqja qoftë mbi ta!), do të arrijmë në përfundimin që ndryshon krejtësisht nga kuptimi i zakonshëm dhe i përhapur mes njerëzve.

Kur e shohim durimin nga këndvështrimi kur'anor dhe ai i haditheve, kuptojmë se ai është si një shtyllë e hekurt që përmbys shkëmbinjtë më të mëdhenj e më të rëndë, largon pengesat dhe vështirësitë më të mëdha, përballet me problemet dhe i kapërcen ato me lehtësi, duke sjellë rezultate plotësisht pozitive. Dhe, në këtë mënyrë, durimi bëhet çelësi i të gjitha dyerve të lumturisë dhe të mirësisë për një shoqëri të shtypur dhe të humbur. Kurse, keqkuptimi i tij mund të shndërrohet në çelës të mjerimit

dhe të fatkeqësisë për tërë shoqërinë. Kur kuptohet drejt, ai bëhet pengesa, freri dhe shqetësimi më i madh për të gjitha forcat e këqija.

Për të njohur konceptin e durimit, përmbajtjen e tij dhe fushat ku jep zgjidhjen më të dobishme e, duhet t'i kthehemi Kur'anit dhe haditheve të Profetit dhe të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), t'i studiojmë dhe t'i analizojmë me kujdes. Vetëm atëherë mund të vërtetojmë kuptimin e saktë të këtij koncepti.

Në Kur'anin e Shenjtë, durimi dhe durimtarët, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qartë, përmenden në më shumë se shtatëdhjetë ajete. Në këto ajete lavdërohen kjo cilësi dhe ata që e zotërojnë atë dhe përmenden pasojat dhe frytet e afërta të saj, duke shtuar kështu shpresën tek ata që kapen fort pas këtij virtyti.

Megjithatë, në këtë studim të shkurtër nuk do të ndalemi tek ajetet kur'anore dhe shpjegimi i tyre. Do të mjaftohemi me shqyrtimin e haditheve dhe nxjerrjen e kuptimeve prej tyre. Zgjedhja e kësaj metode bazohet në dy arsye:

**E para:** Ndalimi tek ajetet kur'anore dhe analiza e ajeteve kur'anore që trajtojnë konceptin e durimit kërkon një studim shumë të gjerë dhe ka nevojë për një hapësirë më të madhe sesa lejon ky punim.

**E dyta:** Mbështetja në hadithe na ndihmon të shmangim harresën dhe neglizhencën që kanë përjetuar transmetimet e të Pagabueshmëve (Paqja qoftë mbi ta!), pasi shumë studime dhe kërkime islame të kohëve të fundit janë privuar prej tyre. Gjithashtu, kjo metodë tregon mënyrën se si mund të përfitohet nga hadithet e shkollës shi'ite për ata që ende nuk janë njohur me rolin e ndritshëm dhe udhëzues të traditës profetike dhe imamite.

Sipas haditheve që na kanë arritur, durimin (*sabrin*) mund ta përkufizojmë në këtë mënyrë: Durimi është qëndresa e njeriut që ecën në rrugën e përsosjes shpirtërore përballë shtysave të këqija, shkatërruese dhe degjeneruese. Për ta kuptuar më mirë këtë, krahasimi është ky: Është një njeri që dëshiron të ngjitet në një mal. Gjatë ngjitjes drejt majave të larta, përballet me pengesa dhe vështirësi. Një pjesë e tyre kanë të bëjnë me vetë atë dhe burojnë nga qenia e tij; një pjesë tjetër vijnë nga faktorët e jashtëm. Të dyja së bashku veprojnë për ta penguar lëvizjen e tij. Pengesat, që burojnë nga vetë njeriu, janë dëshira për rehati, frika, shqetësimi për arritjen e qëllimit dhe prirje të tjera që e pengojnë të vazhdojë ngjitjen dhe përparimin. Si pasojë e këtyre mendimeve dhe pëshpëritjeve, zbehet entuziazmi dhe dobësohen motivet që e çojnë përpara. Faktorët e jashtëm mund të jenë shkëmbinjtë e mëdhenj, ujqërit, ferrat, kusarët e rrugës e pengesa të tjera të ngjashme. Secila prej tyre e kërcënon njeriun dhe përpiket ta ndalojë në

rrugëtimin e tij. Një njeri që përballet me këto vështirësi dhe sprova, ka dy mundësi:

**E para:** Ose vendos të mos e vazhdojë rrugën për shkak të rreziqeve, dhembjeve dhe mundimeve

**E dyta:** Ose ndodh e kundërta: Vendosmëria e tij bëhet më e fortë dhe më e palëkundur. Ai vendos t'u rezistojë të gjitha pengesave të brendshme dhe të jashtme dhe me këmbëngulje, durim dhe qëndrueshmëri i shmang pengesat nga rruga e tij dhe vazhdon udhëtimin drejt qëllimit. Kjo gjendje e dytë është ajo që quhet durim (*es-sabru*).

Në jetën e tij të kufizuar në këtë botë, njeriu është në një rrugë, që shtrihet nga fillimi i jetës së tij tokësore deri në vdekjen e tij. Ai duhet ta përshkojë këtë rrugë për të arritur në shkallët më të larta të njerëzisë dhe përsosjes. Për ta përmbushur këtë synim dhe për t'iu afruar kësaj shkalle të lartë, Allahu ka krijuar për të gjithçka që e ndihmon në këtë rrugëtim. Të gjitha detyrat dhe detyrimet që i janë ngarkuar njeriut janë mjete për t'iu afruar tek Allahu dhe etapa për të ecur drejt qëllimit të dëshiruar.

Edhe shoqëria islame, e cila përbën një nga synimet kryesore të fesë së Allahut dhe të profetëve të mëdhenj (Paqja qoftë mbi ta!), nuk synon tjetër veçse, formimin dhe edukimin e njeriut të përkryer. Profetët e edhe udhëheqësit e frymëzuar nga Allahu dëshironin të krijonin një mjedis të

përshtatshëm që njeriu ta përshkonte këtë rrugë sa më lehtë dhe të arrinte synimin e tij. Ky synim mund të shprehet me pak fjalë: Ai është ngritja dhe përsosja e njeriut, si dhe shpërthimi dhe zhvillimi i aftësive dhe potencialeve, që Allahu ka vendosur brenda tij. Në fenë tonë, kjo gjendje përshkruhet me shprehje të ndryshme, si: *Stolisja me moralin e Allahut (tekhl'luku bi akhlakil'lah), afrimi tek Allahu, përsosja shpirtërore dhe njerëzore dhe shprehje të tjera të ngjashme.*

Natyrisht, në këtë rrugë, e cila është e vështirë dhe e mbushur me prova, ka shumë pengesa, që njeriu duhet t'i kapërcejë. Secila prej këtyre pengesave, e vetme, mund të mjaftojë për ta ndalur këtë udhëtar që po ngjitet drejt zhvillimit dhe majës së përsosjes, duke e penguar që të mos e vazhdojë rrugëtimin e tij.

Te njeriu, në vetë qenien e tij, gjenden të gjitha ato cilësi dhe prirje të këqija e të ulëta morale. Nga ana tjetër, janë edhe faktorët e jashtëm të kësaj bote që sjellin vështirësi, dhembje dhe prova. Ata janë si gjemba në këtë rrugë. Prandaj njeriu që dëshiron të arrijë kulmin e përsosjes, duhet të përballët vazhdimisht me këto pengesa të brendshme dhe të jashtme dhe t'i përballojë ato me qëndrueshmëri, vendosmëri dhe durim. Në këtë kuptim, durimi nuk është nënshtrim para vështirësive, por forcë për t'i mposhtur vështirësitë dhe për të vazhduar rrugën drejt qëllimit që i ka vënë Allahu.

Durimi këtu do të thotë përballje dhe rezistencë me të gjitha këto pengesa me një vullnet të fortë dhe me një vendosmëri të palëkundur, për t'i larguar ato nga rruga.

Siç e përmendëm më parë, të gjitha detyrimet islame, qofshin ato individuale apo shoqërore, janë mjete të domosdoshme të kësaj rruge drejt qëllimit njerëzor. Prandaj, secila prej tyre përbën në vetvete një synim të afërt dhe të ndërmjetëm, që duhet të përmbushet për të arritur qëllimin përfundimtar. Për shembull, ai që dëshiron të udhëtojë drejt një qyteti të largët, duhet të kalojë nëpër vende të ndryshme gjatë rrugës dhe të përgatisë mjetet e nevojshme për udhëtimin. Këto etapa dhe përgatitje konsiderohen si synime të afërta që duhet të përmbushen si parapërgatitje për arritjen e qëllimit kryesor. Në të njëjtën kohë që këto etapa janë mjete për të arritur destinacionin, ato janë edhe qëllime në vetvete për realizimin e hapave të tjerë që vijnë pas tyre. Pra, çdo fazë është njëkohësisht rezultat i një përgatitjeje të mëparshme dhe mjet për një përgatitje të mëtejshme.

Ajo që dua të theksoj me këtë shpjegim është se arritja e secilit prej këtyre synimeve të afërta kërkon një kusht themelor: durimin. Durimi është si një shtizë e mprehtë dhe e fuqishme që çan dhe shkatërron çdo gjë që e pengon arritjen e synimit. Ashtu si në rrugën drejt qëllimit përfundimtar ka shumë pengesa, edhe në rrugën drejt këtyre synimeve të afërta ka pengesa të shumta,- të brendshme dhe të jashtme, që qëndrojnë përballë njeriut

dhe bëhen barriera për zbatimin e secilit prej detyrimeve dhe detyrave islame. Prandaj, durimi është forca që i mund këto pengesa dhe i hap rrugën njeriut drejt përmbushjes së detyrave të tij dhe, në fund, drejt arritjes së përsosjes dhe afrimit me Allahun.

Ndër faktorët që çojnë në ngurtësim dhe plogështim të asaj që buron nga qenësia e njeriut janë: përtacia, prirja për të bërë vetëm atë që është e lehtë, dashuria për veten, mendjemadhësia, lakmia, dëshira për pushtet dhe pozitë, grumbullimi i pasurisë dhe kënaqësia për këtë botë, si dhe shumë cilësi e vese të tjera të ulëta. Faktorët e jashtëm janë: mjediset dhe rrethanat penguese e të papërshtatshme, problemet dhe pasojat që sjellin disa sisteme shoqërore sunduese. Secila prej këtyre pengesave ndikon në largimin e njeriut nga kryerja e detyrimeve që ka caktuar Allahu për të formuar dhe zhvilluar personalitetin. Këto detyrime mund të jenë individuale, si disa forma adhurimi, ose shoqërore, si domosdoshmëria për tëthënë fjalën e së Vërtetës. Ajo që e asgjëson ndikimin e faktorëve negativë, garanton kryerjen e të gjitha detyrimeve që ka caktuar Allahu dhe siguron vazhdimin e ecjes në rrugën e drejtë, është qëndresa njerëzore, pra, përballja e njeriut me pengesat e përmendura. Kjo rezistencë dhe kjo përballje është ajo që quhet durim (*sabr*).

Kur u kthehemi disa haditheve që trajtojnë çështjen e durimit (*es-sabru*), shohim se ato dëshmojnë rëndësinë e madhe të durimit në Islam dhe në të gjitha fetë e Allahut.

Këtë rëndësi mund ta përmbledhim me këtë fjali: Durimi ka qenë porosia e të gjithë profetëve, të evlijave (miqve të Allahut) dhe udhëheqësve të vërtetë për pasuesit e tyre, për trashëgimtarët e tyre dhe për të gjithë ata që ecin në rrugën e tyre. Ja një shembull: Një baba i mëshirshëm dhe një mësuesi i dhembshur. E kanë kaluar jetën në përpjekje dhe luftë të vazhdueshme, duke duruar të gjitha dhembjet dhe vështirësitë për të arritur qëllimin që synonin. Në çastin kur ndahen nga kjo botë, kur dora e tyre nuk është më në gjendje të vazhdojë punën, përpjekjen dhe sakrificën për arritjen e qëllimit, për të cilin e ka shpenzuar jetën, ia besojnë trashëgimtarit vazhdimin e kësaj rruge dhe përmbushjen e këtij misioni. Dhe porositin me për arritjen e atij qëllimi më të lartë.

Cila është vallë kjo porosi e fundit që dikush ia drejton trashëgimtarit të tij, të cilit i është besuar kjo detyrë e rëndësishme dhe e vështirë? Ai nuk do t'i thotë atij veçse atë që është përmbledhja e të gjitha përvojave të tij. Ai do t'i japë frytin e përpjekjeve të tij shkencore dhe praktike, duke u përpjekur ta shprehë atë në një fjali që përmbledh gjithçka të nevojshme. Kjo porosi do të jetë ajo që brenda saj ruan të gjitha njohuritë dhe kuptimet e çmuara, në mënyrë që të shndërrohet në një udhërrëfyes dhe drejtues të përhershëm për atë nxënës dhe trashëgimtar. Pika përfundimtare e jetës së të parit të bëhet pika e fillimit për përsosurinë dhe ngritjen e pasuesit.

Në këtë hyrje, shohim se porosia e fundit e profetëve, eulijave, dëshmorëve, njerëzve të devotshëm dhe e ndërtuesve të shoqërisë, dhe dhurata e fundit mendore që ata u kanë lënë trashëgimtarëve të tyre, ka qenë porosia për durimin.

Tani do të ndalemi në dy hadithe të transmetuara nga Ehli Bejti (Paqja qoftë mbi ta!) lidhur me durimin.

Hadithi i parë është transmetuar nga Ebu Hamza Eth-Themali, i cili thotë: imam Ebu Xha'ferr, imam Muhamed El-Bakir (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kur i erdhi vdekja babait tim, Ali ibn Husejnit, imam Zejnul Abidinit (Paqja qoftë mbi të!), më afroi pranë gjoksit të tij dhe më tha: O biri im, të porosis me atë që më porositi babai im kur i erdhi vdekja dhe me atë që ai më tregoi siç e kishte porositur babai i tij: O biri im, bëj durim në rrugën e së Vërtetës, edhe nëse ajo është e hidhur.”*

Transmetuesit të këtij hadithi, Ebu Hamza Eth-Themali, ishte një nga ndjekësit më të afërt dhe më të sinqertë të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!). Ai ishte ndër figurat themelore për mbrojtjen e shkollës së Ehli Bejtit. Prandaj, ajo që ai ka transmetuar nga imam Bakiri është e saktë dhe e besueshme.

Imam Bakiri e trashëgoi nga babai i tij, imam Zejnul Abidini (Paqja qoftë mbi të!) amanetin e ruajtjes së trashëgimisë së tij, vazhdimin e rrugës së tij dhe të misionit

të tij. Prania e tij ishte vazhdim i pranisë së babait të tij, i cili nga ana e tij ishte vazhdim i misionit të imam Husejn ibn Aliut (Paqja qoftë mbi ta!). Çdonjëri prej imamëve në zinxhirin e Imamatit përfaqësonte vazhdimin e projektit dhe të misionit të atij që kishte ardhur para tij. Dhe të gjithë së bashku ishin vazhdim i ekzistencës dhe misionit të Profetit të nderuar Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij). Të gjithë ata ishin një dritë e vetme dhe një rrugë e vetme, që synonin realizimin e një qëllimi të vetëm.

Nëse i kthehemi hadithit, nga fjalia: *“O biri im, të porosis me atë që më porositi babai im, kur i erdhi vdekja”* kuptojmë se ai, të cilit i referohet, është imam Husejni (Paqja qoftë mbi të!). Për imam Husejnin të gjithë e dimë se ku ishte dhe në çfarë gjendjeje ishte kur i erdhi çasti i vdekjes. Në ato rrethana të jashtëzakonshme të ditës së Ashurasë, në mes të një deti dhembjesh dhe fatkeqësish, dhe në ato kushte të përgjakshme që kishin mbuluar Kerbelanë, ndërsa armiq të kishin rrethuar kampin e imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!), shohim se ai shfrytëzon një mundësi të vogël para se të ndërmernte sulmin e tij të fundit kundër ushtrisë armike.

Ai kthehet nga fusha e betejës në kampin e tij dhe zhvillon një takim të shkurtër me familjen e tij, e cila do të duhej të vazhdonte revolucionin e tij dhe të ndiqte rrugën e tij. Ai flet për një kohë të shkurtër me djalin dhe pasardhësin e tij, Ali ibn Husejnin, imam Zejnul Abidin (Paqja qoftë mbi të!), por kjo bisedë, edhe pse e shkurtër, ishte

jashtëzakonisht e rëndësishme dhe plot me dobi. Këtë njerëzit e quajnë Lamtumira e fundit.

Dhe Imami, siç duhet ta dimë, është i pagabueshëm (*ma'sum*) dhe nuk ndikohet nga emocionet deri në atë shkallë sa ta humbë këtë mundësi të fundit të jetës së tij me fjalë të parëndësishme, duke e kufizuar porosinë e tij vetëm në çështje personale apo emocionale. Një gjë e tillë nuk përputhet me porositë që na kanë ardhur nga Imamët e mëdhenj (Paqja qoftë mbi ta!) dhe nuk i ngjan mënyrës së tyre të udhëzimit. Imami i pagabueshëm (Paqja qoftë mbi të!) e di se në këto orë të ndjeshme që i kanë mbetur nga jeta e tij, duhet ta dorëzojë këtë amanet, për ruajtjen e të cilit ka punuar me gjithë përkushtimin që nga fillimi i imamatit të tij, duke përballuar të gjitha dhimbjet dhe sprovat e mëdha, ashtu siç vepruan para tij themeluesi i revolucionit islam, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), Prijësi i besimtarëve, Aliu (Paqja qoftë mbi të!) dhe imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!). Prandaj, ai duhet t'ia besojë këtë barrë një personi që do të vijë pas tij, një njeriu me forcë, qëndrueshmëri dhe hapa të palëkundur, i cili do ta trashëgojë atë. Prandaj ai shkon tek ai për t'i dhënë porosinë më të rëndësishme, e cila do ta ndihmonte në mbajtjen dhe ruajtjen e atij amaneti.

Cila ishte vallë ajo porosi kaq e rëndësishme dhe e çmuar?

Imam Ali ibn Husejni, Zejnul Abidini (Paqja qoftë mbi të!), martirizimi i të cilit, nuk ishte në të njëjtat rrethana

si martirizimi i babait të tij, imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!), edhe pse jetonte në kushte të ngjashme, e zbulon atë porosi që ia kishte dhënë babai i tij dhe ia përcjell djalit të tij, imam Bakirit (Paqja qoftë mbi të!), si porosi të fundit. Ai, përmend, gjithashtu se porosinë ia kishte transmetuar i ati, imam Husejni, nga babai i tij, Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!). Porosi, e cila ka kaluar përmes zinxhirit të pastër të Imamit, ku çdo Imam ia porosiste atë Imamit pasardhës, ishte: Durimi: *“O biri im, bëj durim në rrugën e së Vërtetës, edhe nëse ajo është e hidhur!”*

Porosia kërkon prej tij që të mos hezitojë gjatë ecjes në rrugën e së Vërtetës, të mos u kushtojë rëndësi pengesave dhe vështirësive dhe, kur ta ketë njohur detyrën që duhet kryer në këtë rrugë, të mos heqë dorë prej saj. Ajo e thërret drejt përballimit, qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë.

Është e qartë se në fushën e përballjes mes së vërtetës dhe së pavërtetës nuk ka vend për rehati, kënaqësi dhe jetë të qetë. Përkundrazi, aty ka sprova, fatkeqësi dhe vështirësi. Prandaj thuhet: ‘Edhe nëse ajo (e Vërteta) është e hidhur.’

Kjo është porosia që u përcoll nga një Imam tek tjetri. Dhe e kemi parë se si Imamët (Paqja qoftë mbi ta!) vepruan sipas saj dhe se si qëndruan të palëkundur deri në çastet e fundit të jetës së tyre, duke pranuar të gjitha pasojat që ajo u sillte. Ata qenë, vërtet mishërimi i këtij vargu të bukur poetik:

*Do të duroj derisa vetë durimi të kuptojë. Se kam duruar diçka më të hidhur se vetë durimi.*

Pasi u bë e qartë nga hadithi i parë rëndësia e durimit dhe pozita e tij në mësimet e Allahut si një thesar i çmuar dhe një trashëgimi e vyer, të cilën Imamët (Paqja qoftë mbi ta!) e zbatuan gjatë gjithë jetës së tyre, kalojmë te hadithi i dytë, që është përcjellë nga Ehli Bejti (Paqja qoftë mbi ta!).

Në librin “Fikh Er-Rida” thuhet: “Na është transmetuar se në porositë e profetëve (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi ta!) thuhej: ‘Bëni durim në rrugën e së Vërtetës, edhe nëse ajo është e hidhur.’ Imami e fillon hadithin e tij me fjalët: “Na është transmetuar ...”. Kjo tregon se bëhet fjalë për një trashëgimi që i është përcjellë Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!). Ata e kanë dëgjuar atë nga etërit dhe paraardhësit e tyre, dhe më pas ua kanë transmetuar të tjerëve, duke i porositur me të. Shprehja: “Në porositë e profetëve...”, do të thotë se porosia e profetëve (Paqja qoftë mbi ta!) për trashëgimtarët e tyre, pasuesit e tyre, ruajtësit e amanetit të tyre dhe ndjekësit e shkollës së Shpalljes së Allahut ishte pikërisht ky mësim: “Bëni durim në rrugën e së vërtetës, edhe nëse ajo është e hidhur.” Kjo është po ajo fjali që pasuesit e Imamëve të pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!) e kanë transmetuar pa asnjë shtesë dhe pa asnjë mungesë. Kjo fjali është ndër shprehjet më të shkurtra që tregojnë rëndësinë e durimit; njëherësh ajo mbart një domethënie dhe një thellësi shumë më të madhe sesa mund të duket në pamje të parë.

Pas këtij vështirimi për rëndësinë e durimit, kalojmë tani te njohja e pozitës së kësaj cilësie shpirtërore dhe rolit të saj brenda tërësisë së mësimave fetare, aq sa ajo ka zënë një vend kaq të rëndësishëm në vëmendjen e miqve të Allahut dhe Imamëve të kësaj feje. Para se të hyjmë drejtpërdrejt në diskutimin për pozitën e këtij koncepti, dëshiroj të sqaroj se çfarë kuptojmë me termin “pozitë” brenda koncepteve dhe mësimave fetare islame.

**Së pari**, feja është një tërësi njohurish, rregullash juridike dhe mësimesh morale. Ajo mbështetet mbi themele intelektuale, të cilat shprehen përmes botëkuptimit që ajo ka për universin dhe për njeriun.

Feja përfshin edhe parimet praktike që burojnë nga ky botëkuptim dhe që përcaktojnë mënyrën e sjelljes dhe të veprimit të njeriut (*ideologjia praktike*). Ajo përcakton marrëdhëniet e domosdoshme të njeriut: me Allahun, me vetveten, me njerëzit e tjerë dhe me krijesat e tjera - gjithmonë brenda kuadrit të këtyre parimeve praktike. Në përputhje me këto, feja përmban një grup urdhrash dhe mësimesh morale që çojnë drejt përsosjes së vërtetë të njeriut përmes përpjekjes, punës dhe seriozitetit. Këto mësimë janë të nevojshme për suksesin në fusha të ndryshme të jetës njerëzore, e cila në rrugën e saj drejt përsosjes ka nevojë për udhëzime të tilla. Pa dyshim, në një sistem të tillë shoqëror dhe fetar ekzistojnë çështje individuale, që lidhen drejtpërdrejt me interesat personale

të individit dhe çështje shoqërore, që lidhen me bashkësinë njerëzore dhe me bashkësinë myslimane.

Nëse kthehemi te pika kryesore e këtij studimi, shtrojmë pyetjen: Cili është roli dhe ndikimi i durimit brenda kësaj tërësie dijeshe dhe rregullash që përbëjnë fenë? Me fjalë të tjera, cili është roli i durimit në formimin e njeriut, që i ka besuar fesë, pra që beson në parimet dhe bindjet e saj, angazhohet në zbatimin e mësimave dhe të urdhrave të saj dhe ka cilësitë morale që kjo fe i ka kërkuar?

Për shembull, te figurat gjeometrike brinjët, këndet, vijat dhe kulmet kanë një ndikim themelor në formën dhe ndërtimin e tyre. Atëherë, cila është pozita e durimit dhe ndikimi i tij në strukturën gjeometrike të besimit (imanit)?

Për ta sqaruar më mirë këtë çështje, le të marrim një shembull: Një autobus udhëtarësh, mund të përshkojë distanca të gjata dhe t'i çojë udhëtarët së bashku me bagazhet e tyre në destinacionin e dëshiruar në mënyrë të sigurt, sepse ai ka një element themelor - motorin.

Motori e merr forcën e lëvizjes nga karburanti. Durimit, është si motori i autobusit. Autobusi është feja e Allahut. Madje, durimin mund ta konsiderojmë edhe si karburantin që e vë në lëvizje motorin.

Pra, ashtu si një mjet transporti nuk mund ta arrijë destinacionin pa motor dhe pa karburant, edhe njeriu nuk

mund ta përshkojë rrugën e besimit, të veprimit dhe të përsosjes shpirtërore pa durimin, sepse ai është forca shtytëse që e mban atë në lëvizje drejt qëllimit që na ka caktuar Allahu.

Nëse nuk do të ekzistonte durimi nuk do të ishte e mundur të kuptohej logjika e fesë së vërtetë. As dijet për fenë, të cilat janë dituritë më të larta njerëzore në botë, nuk do ta kishin këtë pozitë që kanë. Pa durimin nuk do të rronte shpresa dhe pritja e asaj dite, kur kjo fe do të triumfojë. Besimtarët do ta humbnin qëndrueshmërinë dhe forcën e nevojshme. Zbatimi i mësimave fetare, të cilat shpesh bien ndesh me instinktet dhe dëshirat e shfrenuara njerëzore, do të ndalej. Nëse do të mungonte durimi, atëherë të flitej për xhihadin në Rrugën e Allahut dhe për lartësimin e Fjalës së Allahut do të ishte fjalë pa kuptim.

Edhe tubimi madhështor botëror, që është Haxhi, ku njerëzit mbledhen nga vende të largëta, do të shndërrohej në një vend të zbrazët dhe të heshtur. Zërat që i luten Allahut në errësirën e netëve do të shuheshin. Fusha e luftës kundër vetvetes (*xhihadi en-nefs*) do ta humbiste shkëlqimin e saj dhe arteriet e jetës ekonomike të shoqërisë islame do të tkurrëshin, sepse njerëzit do të largoheshin nga shpenzimi në Rrugën e Allahut. Po të mos ishte durimi, të gjitha vlerat praktike dhe morale të Islamit, si devotshmëria, besnikëria, sinqeriteti, vetëpërmbajtja dhe ruajtja nga mëkatet, do të lireshin në harresë. Përmbledhtas, ajo që duam të themi është se, po të mos ekzistonte ai që quhet durim në kulturën

islame, çdo njeri do të mbetej larg njerëzisë dhe fesë, sepse të dyja kërkojnë përpjekje, punë dhe sakrificë. Këto nuk mund të realizohen pa një kusht themelor: durimin. Feja është veprim dhe veprimi realizohet me durim. Ajo që u jep shpirt dhe fuqi mësimëve dhe dispozitave fetare dhe që e vë në lëvizje trenin e tyre drejt synimit, është pikërisht durimi.

Besojmë që me shpjegimin që u dha më sipër, ne mund ta kuptojmë domethënien dhe mesazhin e këtij frymëzimi nga Allahu që na ka arritur përmes Imamëve të pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!), me dallime të vogla në formulim nga një transmetues tek tjetri: *“Durimi në besim është si koka në trup.”*

Koka është qendra dhe shtylla e jetës. Pa kokën, trupi nuk ka asnjë kuptim. Nëse trupi humbet ndonjë nga pjesët e tij të dukshme, si dorën, këmbën etj, ai mbetet ende i gjallë. Pa kokën, të gjitha pjesët e tjera të trupit paralizohen. Mund të ndodhë që ato gjymtyrë të mbeten biologjikisht të gjalla, por nuk do të jenë më në gjendje të kryejnë asnjë veprim dhe as të ushtrojnë ndonjë ndikim. Në atë rast, pothuajse nuk ka dallim mes jetës dhe vdekjes së tyre. Ne e ndiejmë drejtpërdrejt rolin e syrit, të dorës, të këmbës etj. Por e gjithë kjo vlerë ekziston vetëm falë pranisë së kokës. Kështu është edhe çështja e durimit.

Kur humbet durimi, Teuhidi (Njëshmëria e Allahut) nuk është i qëndrueshëm. Edhe profetësia dhe misioni i profetëve nuk do të mund t'i përmbushnin synimet e tyre.

Nuk do të ishte e mundur të themelohej dhe të ndërtohej shoqëria hyjnore islame, as të riktheheshin të drejtat e të shtypurve. Madje, edhe namazi, agjërimi dhe të gjitha adhurimet e tjera do ta humbnin bazën dhe themelin mbi të cilin mbështeten. Prandaj, themi se durimi është ai që i jetëson bindjet, idealeve dhe qëllimet fetare e njerëzore.

Po të mos kishte qëndruar i palëkundur Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) në fillim të Shpalljes, po të mos kishte qëndruar i fortë përballë pengesave dhe vështirësive, që u ngritën si mur para Islamit, Islami nuk do të kishte dalë kurrë përtej katër mureve të shtëpisë së vetë Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!).

Dhe Dëshmia madhështore “Nuk ka zot tjetër, përveç Allahut” do të ishte zhdukur dhe do të ishte shuar që në fillimet e tij.

Kjo tregon se durimi nuk është, thjesht një virtyt moral mes virtyteve të tjera, ai është forca jetësore që mban gjallë besimin, misionin për Allahun dhe të gjitha vlerat e Islamit.

Ajo që e ka ruajtur Islamin është durimi. Po të mos kishin duruar miqtë e Allahut dhe profetët e Tij të mëdhenj, asgjë nga Teuhidi (Njëshmëria e Allahut) nuk do të kishte mbërritur deri te ne. Faktori që e ruajti thirrjen e Allahut, që e mbajti të fortë dhe të pathyeshëm litarin e Teuhidit, dhe që

do ta ruajë atë deri në Ditën e Kiametit, është pikërisht durimi i bartësve të flamurit të këtij mendimi dhe besimi.

Nëse bindjet dhe shpresat njerëzore nuk shoqërohen me durimin dhe qëndrueshmërinë e atyre që besojnë në to dhe i thërrasin njerëzit drejt tyre, ato nuk do të kalojnë përtej gjuhës. Ato do të zhduken përballë valëve të trazuara të ngjarjeve historike. Kështu bëhet i qartë kuptimi i hadithit: *“Durimi në besim është si koka në trup.”*

Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), i ka bërë aluzion kësaj të vërtete në hytben “El-Kasí’ah”, kur analizon revolucionin e të shtypurve dhe fitoren e tyre mbi tiranët. Ai thotë: *“Kur Allahu pa qëndresën e tyre të singertë në përballimin e vuajtjeve për hir të dashurisë së Të dhe durimin e tyre para gjërave të urryera për hir të feikës nga Ai, Alla i nxorri nga ngushticat e sprovave. Ai ua zëvendësoi poshtërimin me krenari dhe frikën me siguri. Kështu ata u bënë sundues dhe prijës të dalluar dhe fituan një nderim nga Allahu, që shpresat e tyre nuk kishin mundur ta përfytyronin.”*

Kjo është ligjësi historike dhe e përhershme, që do të mbetet e vlefshme përgjithmonë.

Fjalinë se: *Durimi është qëndresa para të gjitha shkaqeve dhe faktorëve që çojnë drejt së keqes, korrupsionit dhe degjenerimit*, mund ta zgjerojmë dhe të themi se cilat janë situatat, në të cilat kërkohet të stolisemi me durim dhe të kapemi fort pas tij.

Kur'ani dhe hadithet e bekuara na mësojnë se njeriut, që është durimtar dhe qëndrestar në durim, i është premtuar një shpërblim i madh në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Dhe, nuk ka dyshim se ata që dalin përballë bartësve të flamurit të së vërtetës dhe drejtësisë, përballë heronjve që përbëjnë pararojën e ushtrisë së Islamit dhe ata që e ndotin veten me bindjen ndaj zotërinjve të tyre egoistë e interesaxhinj në fushën e kësaj beteje dhe ata që luftojnë kundër thirrjes për të vërtetën për të fituar pasuri, përfitime dhe pozitë dhe ata që e pengojnë dhe e kundërshtojnë të vërtetën duke ndjekur pasionet dhe dëshirat e tyre - të gjithë këta mund të përshkruhen, gjithashtu si njerëz që durojnë dhe qëndrojnë në rrugën e tyre. Mund të quhen me fjalën “durimtarë”, por ata janë shumë larg kuptimit të vërtetë të konceptit durim. Përse? Sepse përpjekja dhe qëndrueshmëria e tyre nuk është në rrugën e përsosjes së njeriut. Ata po qëndrojnë kundër shfaqjeve dhe dritës së përsosjes dhe lartësimit të njeriut. Prandaj, ata dalin jashtë konceptit të durimit sipas terminologjisë kur'anore dhe terminologjisë së haditheve.

Durimi i vërtetë është te veprat dhe përpjekjet për përsosjen e njeriut. Vetëm kjo qëndrueshmëri e ndihmon njeriun të ecë drejt së vërtetës, moralit, drejtësisë dhe afrimit me Allahun. Dhe vetëm kjo qëndrueshmëri meriton të quhet durim (*sabr*) në kuptimin e tij të mirëfilltë islam. Atje ku është qëllimi i vërtetë i krijimit të njeriut, ku është synimi

përfundimtar i njerëzimit - shndërrimi i njeriut në një rob të vërtetë të Allahut dhe shfaqen aftësitë dhe potencialet të fshehura përmes lëvizjes dhe përpjekjes - pikërisht aty përshfaqet kuptimi i durimit dhe fusha e tij. Aty kërkohet qëndresë dhe qëndrueshmëri përballë nxitjeve dhe faktorëve që pengojnë këtë përpjekje dhe këtë ecje përpara.

Ato faktorë, qofshin të brendshëm apo të jashtëm, të cilët i kemi përmendur më parë, shpesh bashkëveprojnë në ndikimin e tyre dhe në shumë raste janë shembuj të kurtheve dhe mashtrimeve të shejtanit.

Kur dëshirojmë të ecim në rrugën e vështirë të përmbushjes së detyrave fetare dhe përballemi me pengesa e vështirësi të ndryshme – qofshin ato pengesa negative apo pengesa pozitive dhe të tërthorta, ndodh diçka e ngjashme me shembullin e alpinistit që përmendëm më parë. Gjatë ngjitjes së tij, pamjet tërheqëse ose shoqëria e një personi që mbjell dyshime dhe ngurrim, mund ta shtyjnë atë të hedhë çantën e shpinës në tokë dhe ta zëvendësojë vendosmërinë për t'u ngjitur me plogështi dhe kënaqësi për të qëndruar në atë vend të bukur. Në raste të tjera, sëmundja, kujdesi për një të sëmurë ose kujtimi i ngjarjeve të dhembshme dhe pikëlluese mund ta dobësojnë vullnetin dhe ta ndërpresin rrugëtimin. Ky lloj i fundit përbën një pengesë të një natyre tjetër, pra, një pengesë të tërthortë. Të tria këto lloje pengesash qëndrojnë në rrugën e përsosjes së njeriut.

Nëse i konsiderojmë detyrimet fetare si mjete të këtij udhëtimi, ndalesat fetare (haramet) si devijime nga kjo rrugë dhe ngjarjet e hidhura e të dhembshme të jetës si faktorë që sjellin paqëndrueshmëri psikologjike dhe dobësim të vendosmërisë, atëherë mund t'i ndajmë pengesat në këtë mënyrë:

*a- Shkaqet që e shtyjnë njeriun të lërë detyrimet (farzet).*

*b-Shkaqet që e shtyjnë njeriun të kryejë vepra të ndaluara (harame) dhe mëkate.*

*c- Shkaqet që sjellin gjendje paqëndrueshmërie dhe lëkundjeje shpirtërore.*

Durimi, është rezistenca dhe mosdorëzimi përballë këtyre tri shkaqeve, të cilët pa dyshim sjellin pas korrupsionin, të keqen dhe rënien e njeriut.

Me këtë thënie, mund ta kuptojmë më thellë hadithin që Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), e transmeton nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): “Durimi është tri llojesh: durimi gjatë fatkeqësisë, durimi në bindje dhe adhurim dhe durimi larg mëkatit.” Në secilin prej këtyre tri rasteve - kur njeriu përballet me ngjarje të dhembshme dhe të hidhura në jetë, kur kërkohet prej tij të kryejë një detyrë fetare, ose kur diçka e ndjell drejt një mëkati, shfaqet forca, heroizmi dhe qëndrueshmëria e shpirtit.

Për ta kuptuar plotësisht këtë koncept islam, do të sqarojmë secilin prej këtyre tri llojeve të durimit.

## **Durimi kur kryejmë detyrat fetare**

Përballë çdo detyre ose detyrimi qëndrojnë vështirësi dhe pengesa, sepse, nga njëra anë, kërkohet përpjekje për ta kryer detyrën, dhe nga ana tjetër, njeriu ka prirjen për rehati dhe qetësi. Detyrimet e zakonshme individuale, si namazi, agjërimi dhe parapërgatitjet e nevojshme për to, detyrimet financiare, shpenzimet në rrugën e Allahut, Haxhi, përgjegjësitë e rëndësishme shoqërore, detyrat që kërkojnë sakrifica, pasuri dhe heqjen dorë nga zbukurimet e jetës - të gjitha këto nuk përputhen plotësisht me natyrën e njeriut: Megjithëse me shpirt njeriu kërkon ngritje dhe përsosje, është i prirur njëherësh drejt rehatisë dhe lehtësisë.

Kjo gjendje nuk kufizohet vetëm te detyrimet fetare. Ajo vërehet në të gjitha detyrimet, ligjet dhe sistemet e botës, qofshin ato fetare apo njerëzore, të drejta apo të gabuara. Në çdo sistem, arritja e qëllimeve të larta kërkon përpjekje, disiplinë dhe përballim të vështirësive, kurse prirja natyrore për rehati përbën pengesën, që duhet kapërcyer me durim dhe vendosmëri.

Në thelb, edhe pse ligji është i domosdoshëm për njeriun dhe ai e pranon këtë domosdoshmëri, në përgjithësi, nuk e sheh atë si diçka të ëmbël a të pëlqyeshme. Madje, edhe ligjet e zakonshme njerëzore që zbatohen në botë, të

cilat kanë rezultate të qarta dhe pozitive dhe pasojat e shkeljes së tyre janë të njohura për të gjithë, si, p.sh., rregullat e trafikut, nuk bëjnë përjashtim nga ky parim. Megjithëse mijëra aksidente të përgjakshme dhe tragjike ndodhin si pasojë e mosrespektimit të këtyre rregullave, dhe shumica e njerëzve i shohin këto pasoja me sytë e vet, përsëri rrallë gjen një drejtues makine që nuk mërzhitet, kur duhet të ndalet te semafori i kuq ose kur një shenjë trafiku e pengon të shkurtojë rrugën. E njëjta gjendje vlen edhe për ligjet e tjera. Edhe detyrimet fetare, megjithëse janë ligjëruar në përputhje me natyrën e pastër të njeriut (*fitren*) dhe me nevojat e tij të vërteta dhe megjithëse janë mjete për përsosjen dhe ngritjen e tij, kur zbresin në fushën e zbatimit praktik, shoqërohen me një shkallë të caktuar vështirësie dhe mundimi, pavarësisht madhësisë së tyre.

Për shembull. Namazi, kërkon vetëm pak minuta nga koha e njeriut. Për ta falur namazin njeriu duhet lërë mënjanë angazhimet të nevojshme ose të panevojshme. Po ashtu, të sigurojë kushtet e domosdoshme për faljen e namazit, si veshja e përshtatshme, vendi i përshtatshëm e të tjera. Të gjitha këto janë, në një masë të caktuar, në kundërshtim me prirjet e natyrshme të unit dhe dëshirat e njeriut.

Gjatë namazit, duhet të arrihet përqendrimi i zemrës (*hudhurul-kalb*), përkushtimi ndaj veprimeve dhe përmendjeve të tij, largimi i mendimeve dhe shqetësimeve që e shpërqendrojnë njeriun nga Allahu, si dhe mbyllja e

dyerve të shpirtit ndaj ideve dhe kujtimeve të rastësishme, janë kushte të domosdoshme për përsosmërinë e namazit dhe për realizimin e efekteve të tij.

Pra, namazi kërkon përpjekje dhe mundim shpirtëror. Kryerja e tij në mënyrën e duhur kërkon një forcë të madhe të brendshme dhe një kapital të çmuar shpirtëror. Ky kapital janë, në radhë të parë, durimi dhe qëndrueshmëria.

Agjërimi kërkon të mos hash ushqim dhe të mos pish ujë për disa orë, edhe pse të hahet dhe të pihet. Dhe besimtati nuk u dorëzohet kërkesave të barkut dhe epsheve. Kur buzët thahen dhe barku i zbrazët shtrëngohet në një ditë të nxehtë vere, njeriu duhet të ketë një kapital të mjaftueshëm shpirtëror, bashku me vullnetin dhe vendosmërinë. Por, këto janë vepra të vështira që kërkojnë qëndresë dhe aftësi për të duruar.

Po kështu është edhe Haxhin. Haxhi ka lodhjen e udhëtimit, largimin nga familja dhe vendlindja, bashkimin me një grup njerëzish të panjohur dhe shpenzimin e pasurisë. Të gjitha këto kushte nuk kanë të bëjnë me turizëm a tregti. Përkundrazi, qëllimi është vetëm: “Kryerja e Haxhit në Shtëpinë e Allahut.” Dhe kjo është një punë e vështirë.

Po ashtu, i vështirë është edhe urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, Dhe xihadi në rrugën e Allahut. Mbase, nuk kemi nevojë të numërojmë më tej vështirësinë

dhe mundimet e këtyre detyrimeve. Pengesat e vështirësitë që qëndrojnë në rrugën e tyre janë të njohura për të gjithë.

Të shpallësh fjalën e së Vërtetës dhe ta përcjellësh atë te njerëzit e së pavërtetës, të jesh i gatshëm të përballosh të gjitha hidhërimet dhe dhembjet kur përballesh me pushtetin e padrejtësisë, i cili nxjerr shpatën dhe ngre kamxhikun e tij dhe të qëndrosh përballë ujqërve grabitqarë nga sytë e të cilëve shkëlqen kërcënimi i shpatave të mprehta që depërtojnë deri në thellësinë e zemrës - e gjithë kjo rezistencë nuk është aspak e lehtë. Nuk është e lehtë as për një individ dhe as për një popull; përkundrazi, është ndër veprat më të vështira dhe më të rrezikshme. Ky është realiteti i detyrimeve islame. Ato shoqërohen me sprova, vështirësi dhe dhembje, edhe pse në vetvete përmbajnë faktorët dhe mjetet më të domosdoshme e më të dobishme për përmirësimin e njerëzimit dhe lumturinë e tij. Pa dyshim, për ata që e kanë njohur rrugën e drejtë dhe të udhëzimit, kjo çështje do të jetë e ëmbël, sepse është në Rrugën e Allahut dhe drejt qëllimit të shenjtë e të lartë të njerëzimit. Për njerëz të tillë, të gjitha hidhërimet dhe vuajtjet shndërrohen në diçka të ëmbël dhe të përballueshme. Edhe vetë namazi, për të cilin përmendëm ato kushte dhe vështirësi, është i ëmbël dhe i dashur për njerëzit e Allahut. Ata e shijojnë ëmbëlsinë e tij dhe e përjetojnë kënaqësinë shpirtërore që ai sjell. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), kur afrohej koha e namazit, i

thoshte myezinit Bilal *“Na qetëso, o Bilal.”* Kështu është edhe me xhihadin në Rrugën e Allahut. Për njerëzit me zemra të forta, si Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ai sjell gjallëri dhe energji dhe ata e shohin atë si një rrugë drejt lumturisë dhe qëndrueshmërisë.

Në një nga hytбет e tij në *“Nehxhul Belaga”*, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e shpjegon atë gjendjeje të lartë dhe të mahnitshme shpirtërore: *“Ne ishim me të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe vrisnim baballarët tanë, bijtë tanë, vëllezërit tanë dhe xhaxhallarët tanë. Dhe kjo na shtonte veçse besim, dorëzim (para Allahut), ecje të palëkundur në rrugën e drejtë dhe durim ndaj hidhësisë së dhimbjes.”*

Pas këtij shpjegimi, shtrojmë pyetjen: Çfarë duhet të bëjë njeriu besimtar me këto vështirësi dhe mundime gjatë kryerjes së detyrimeve fetare? A mund ta lëmë namazin sepse është i vështirë?! Apo ta lëmë përpjekjen për të arritur praninë e zemrës (*hudhurul-kalb*) dhe largimin e mendimeve shpërqendruese sepse është e vështirë?!

Po kështu, në detyrimet e tjera, si xhihadi, Haxhi, urdhërimi për të mire, dhe ndalimi i së keqes, si dhe detyrimet e tjera shoqërore që kanë lodhje dhe vështirësi, a është e drejtë që ne të qëndrojmë duarkryq përballë dëshirave të egos sonë dhe kërkesës për rehati e lehtësi?

Këtu vjen përgjigjja e Islamit: Jo, kjo nuk është e drejtë. Përkundrazi, duhet durimi. Duhet durimi te bindje në Allahun. Ne duhet t'u bëjmë ballë atyre pëshpëritjeve që na shfaqen gjatë namazit dhe që duan ta shpërqëndrojnë zemrën e ta bëjë të harrojë se qëndron para Allahut në vendin e adhurimit. Duhet të bëjmë durim përballë tyre, derisa ta çojmë namazin drejt përsosurisë dhe derisa ai të japë frytin dhe ndikimin e tij të vërtetë. Përballë dëshirave të shumta dhe të forta, që e shtyjnë njeriun të prishë agjërimin në një ditë të gjatë dhe të nxehtë të muajit të Ramazanit, ne duhet të kemi durim dhe qëndresë.

Kur hyjmë në fushën e përballjes me armikun, i cili skërmit dhëmbët e armiqtësisë dhe dëshiron të na shfarosë, ne duhet të nxitojmë të largohemi nga çdo gjë që na kujton kënaqësitë e kësaj bote, ëmbëlsinë e jetës, fëmijët, të dashurit, angazhimet materiale dhe interesat personale; ne duhet të largohemi nga gjithçka që mund të shkaktojë lëkundje dhe dobësim të vullnetit.

Kur themi "duhet të kemi durim", do të thotë që nuk duhet të lejojmë që frika të depërtojë në zemrat tona për shkak të kërcënimeve dhe zhurmës së tiranit, padrejtësia dhe arroganca e të cilit sjellin shkatërrimin e ymetit dhe rënien e tij. Përkundrazi, duhet të zbulojmë turpin dhe poshtërimin e tij nga maja e lartë e qëndrueshmërisë dhe durimit.

Kur themi “duhet të kemi durim”, do të thotë se duhet t’u bëjmë ballë joshjeve të shejtanit, i cili shfaqet në një mijë forma e mënyra për të na penguar nga dhënia dhe shpenzimi në Rrugën e Allahut. Shejtani e bën këtë duke na kujtuar nevojat tona personale, duke na zhytur në interesat tona, në dashurinë për grumbullimin dhe shtimin e pasurisë, dhe duke na penguar kështu nga kryerja e detyrimeve tona financiare, si khumsi (një e pesta e pasurisë), zekati, sadakaja etj. Ai përpiqet të na bëjë që ndriçimi i shtëpive tona të na duket më i rëndësishëm sesa ndezja e një qiriri në xhami. Ne duhet të rezistojmë, dhe rezistenca jonë duhet të jetë në gjithçka që kemi për detyrë ta kryejmë.

Në fushën e betejës duhet të ketë qëndrueshmëri dhe palëkundshmëri.

Në fushën e luftës kundër egos (*xhihadu en-nefs*) duhet të ketë vazhdimësi dhe këmbëngulje.

Në një vend tjetër duhet të mos i kushtojmë rëndësi varfërisë dhe pëshpëritjeve që ajo sjell.

Kjo qëndresë është durimi.

Durimi nuk është dorëzim, as lidhje e duarve dhe burgosje e vullnetit përballë ngjarjeve të përditshme, duke u bërë i pavëmendshëm para asaj që ndodh rreth nesh. Përkundrazi, durimi është qëndrueshmëri aktive, është forcë e brendshme që e mban besimtarin në rrugën e së vërtetës përballë çdo pengese.

## **Durimi në bindjen para Allahut në jetën e Imamëve (Paqja qoftë mbi ta!)**

Në tekstet e vizitave (*zjariateve*), me të cilat vizitohen Imamët (Paqja qoftë mbi ta!), ndër cilësitë që përmenden dhe theksohen vazhdimisht në ato tekste, është durimi. Ne u drejtohem Imamëve duke thënë: “Ti ke duruar, ke kërkuar shpërblimin tek Allahu...” Pra, i drejtohem Imamit duke i thënë se ai ka duruar, e ka llogaritur shpërblimin e tij tek Allahu, është ngritur në Rrugën e Allahut, e ka mbajtur amanetin, pavarësisht të gjitha vështirësive dhe mundimeve dhe e ka përmbushur amanetin siç duhej.

Vërtet, përgjegjësia e udhëzimit të njerëzve, sqarimi i të vërtetave, përballja me tiranët dhe luftimi i padrejtësisë e i korrupsionit ishte detyrë e mbushur me vështirësi dhe vuajtje dhe kërkonte durim dhe rezistencë të jashtëzakonshme.

Është e sigurt se, po të ishte durimi i Imamit vetëm të qëndronte i trishtuar dhe i pikëlluar për gjendjen e keqe të kohës së tij, t’i digjej zemra për atë që po u ndodhte Islamit dhe myslimanëve, ndërkohë që rrinte i mbyllur në shtëpi, duke përtypur dhembjet dhe hidhërimet, pa lëvizur për të luftuar korrupsionin e ndryshuar gjendjen ekzistuese, për të

reformuar shoqërinë dhe për ta lartësuar atë, atëherë kjo nuk do të konsiderohej një nga virtytet dhe madhështitë e tij. Kjo lloj gjendjeje mund të jetë te çdo njeri, sidomos te njerëzit e dobët dhe tek ata që nuk ndiejnë përgjegjësi.

Durimi, virtyti që përmendet në tekstet e vizitave (zijareteve) është tipar i shquar në jetën e Imamëve (Paqja qoftë mbi ta!). Dhe ai duhet të jetë për ne mësim frymëzues e ta kujtojmë vazhdimisht. Është durimi në kryerjen e detyrës që njerëzit e tjerë nuk mundën ta bartnin dhe ta përmbushnin; është durimi te bindje para Allahut dhe te kryerja e deturimit para Allahut. Ky është durimi i Imamëve. Ai nuk ishte durim pasiv, por durim aktiv, i shoqëruar me sakrificë, përpjekje, përgjegjësi dhe qëndresë në Rrugën e së Vërtetës.

## Një vështrim në Kur'an

Në dhjetëra ajetet e Kur'anit që flasin për durimin dhe durimtarët, durimi te bindja para Allahut është një nga më kryesorët.

Për shembull, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ عَشْرُونَ صَابِرُونَ يَغْلِبُوا مِائَتِينَ وَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ مِائَةٌ يَغْلِبُوا أَلْفًا بِإِذْنِ اللَّهِ﴾

**“Nëse prej jush janë njëzet durimtarë, do të mposhtin dyqind; e nëse janë njëqind, do të mposhtin - një mijë me lejen e Allahut.”<sup>3</sup>**

Në këtë ajet, Allahu na tregon se durimi nuk është gjë tjetër, veçse qëndresë dhe palëkundshmëri përballë vështirësive, që i dalin përpara luftëtarit në fushën e betejës. Ky kuptim është shumë i qartë në ajet.

Durimtarët që përmenden këtu, janë ata, që nuk i pengojnë shkëlqimet e shpatave dhe kërcënimet e armiqve nga kryerja e detyrës së tyre. Ata nuk ndalen as nga kujtimi i fëmijëve, të afërmve dhe jetës së rehatshme e të qetë. Asgjë

---

<sup>3</sup> Sure “El-Enfal”, ajeti 65.

nuk i largon ata nga xhihadi në Rrugën e Allahut dhe nuk i bëjnë të lëkunden në këtë bindje dhe adhurim.

Një ajet tjetër i Kur'anit thotë:

﴿رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَثَبِّثْ أَفْئَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ﴾

**“Zoti ynë! Na jep durim të madh, na i forco hapat dhe na jep fitore kundër popullit mohues.”<sup>4</sup>**

Në këtë ajet përmendet një grup besimtarësh që po drejtohen drejt fushës së betejës për të kryer detyrën e tyre. Ata janë përgatitur dhe janë pajisur për t'u përballur me një armik të fuqishëm.

Ata i luten Allahut që t'u japë shpirtin e qëndrueshmërisë dhe rezistencës, në mënyrë që të përballojnë pengesat që mund t'i ndalin në rrugë dhe të arrijnë frytin e synuar, që është fitorja.

Ka edhe shumë ajete të tjera që trajtojnë durimin në bindje ndaj Allahut, por shqyrtimi i tyre kërkon një trajtim më të gjerë dhe më të detajuar.

---

<sup>4</sup> Sure “El-Bekare”, ajeti 250.

## **Durimi para mëkatit**

Te çdo njeri ka prirje natyrore dhe dëshira që e shtyjnë të kryejë disa veprime dhe të largohet nga disa të tjera. Në të vërtetë, këto janë forca që e shtyjnë njeriun të përpiqet dhe të luftojë gjatë të gjitha etapave të jetës së tij. Këto prirje quhen instinkte. Shembujt janë: dashuria për fëmijët, dashuria për pasurinë, dëshira për pushtet, dëshira seksuale e të tjera.

Tani shtrohet pyetja: Si i ka trajtuar Islami këto instinkte njerëzore? Si i ka përcaktuar kufijtë dhe mënyrën e duhur të përbaljes me to? A duhet vallë që ato të shuhet dhe të shtypen plotësisht përmes ushtrimeve të rënda asketike? Apo nuk duhet të ketë asnjë kufizim dhe asnjë kusht dhe njeriu duhet t'u dorëzohet atyre dhe t'i ndjekë kudo që ta çojnë?

Përgjigjja është: Islami nuk e konsideron të drejtë asnjëherë prej këtyre dy qasjeve. Islami nuk e mohon ekzistencën e këtyre instinkteve njerëzore. Përkundrazi, i konsideron ato një realitet që nuk duhet shpërfillur dhe i sheh si të dobishme dhe të nevojshme. Por, nga ana tjetër, ai mbyll rrugën e tiranisë, të tejkalimit të kufijve dhe devijimit të keq të tyre përmes një vargu masash të mençura dhe vendosjes së kufijve realë e të drejtë.

Në të vërtetë, vetë ekzistenca e instinkteve të njeriut është një mjet për vazhdimin e jetës dhe përmbushjen e nevojave themelore të saj. Por, kur këto instinkte dalin jashtë kontrollit dhe devijojnë, ato bëhen shkak për shkatërrimin e jetës dhe të përsosjes së saj. Një shembull: instinkti i dashurisë për vetveten. Po të mos ekzistonte ky instikt, jeta në tokë nuk do të vazhdonte. Pikërisht për shkak të këtij instinkti njeriu mbron veten dhe largohet nga rreziqet dhe shkatërrimi.

Mirëpo, kur ky instinkt i tejkalon kufijtë e duhur, jeta shndërrohet në një varg vuajtjesh dhe fatkeqësish. Madje, ndonjëherë mund të arrijë deri aty sa bashkëjetesa të bëhet e pamundur. Po kështu duhet të kuptohen edhe të gjitha instinktet e tjera.

Këtu del roli i durimit para mëkatit, i cili është një nga tri llojet e durimit. Ai nënkupton rezistencën ndaj vrullit të instinkteve, kur ato rebelohen dhe dalin jashtë kufijve të tyre, si dhe përballimin e devijimeve që burojnë prej tyre. Sepse baza dhe rrënja e të gjitha mëkateve dhe gjynaheve është pikërisht ky teprim dhe ky devijim i instinkteve nga rruga e drejtë.

Njeriu, në mënyrë të natyrshme, anon drejt sigurimit të mjeteve të jetesës dhe nevojave themelore të saj. Meqenëse këto zakonisht nuk sigurohen pa pasuri dhe të ardhura, ai përpiqet t'i fitojë ato. Kjo është një nga shfaqjet e instinktit njerëzor. Islami, i cili përfaqëson shkollën e vërtetë

njerëzore dhe rrugën që njeriu duhet të ndjekë në jetë, e ka pranuar këtë nevojë. Mirëpo, për të siguruar rregullin dhe drejtësinë në shoqëri, ai ka vendosur një varg rregullash dhe ligjesh për përmbushjen e kësaj prirjeje natyrore (fitimin e pasurisë). Prandaj, Islami nuk e ndalon aspak njeriun të përpiqet dhe të punojë për të siguruar nevojat e jetesës. Përkundrazi, e konsideron këtë një vepër të natyrshme dhe të nevojshme. Megjithatë, ka shumë raste kur ky instinkt del jashtë kufirit të ekuilibrit. Atëherë, grumbullimi dhe akumulimi i pasurisë shndërrohet në sëmundje të rrënjosur në shpirtin e njeriut. Pasuria nuk mbetet më mjet për përmbushjen e nevojave jetësore, por bëhet qëllim në vetvete, i dashur dhe i adhuruar. Në këtë gjendje, ajo shndërrohet në një mjet për realizimin e synimeve çnjerëzore dhe në shkak për mburrje të kotë dhe epërsi ndaj të tjerëve. Kjo është e papranueshme dhe e ndaluar në Islam. Dhe këtu ndërhyt Islami për t'u paraqitur ithtarëve të tij parimin e durimit, domethënë, i urdhëron ata të qëndrojnë përballë këtij teprimi dhe këtij devijimi të instinktit. Për shembull, kur instinkti i dashurisë për pasurinë del jashtë kontrollit, njeriu mund të shkojë te kamata (*riba-ja*), monopolizim dhe forma të tjera të fitimit të padrejtë, ose kryen veprime e transaksione që nuk i takojnë dinjitetit të tij njerëzor. Në këtë rast, durimi do të thotë të rezistosh para faktorëve që çojnë në këtë korrupsion dhe në devijime të ngjashme.

Marrim prirjen natyrore të njeriut për pushtet dhe fuqi: Nëse kjo prirje do të mungonte, njeriu do të pranonte poshtërimin, nënçmimin dhe përruljen. Ne jemi të bindur se një njeri i tillë do të kishte një natyrë të devijuar dhe një fitre të shtrembëruar. Prandaj Islami ka sjellë një metodë të veçantë për këto raste, e cila mund të përdoret për ta orientuar këtë prirje në drejtimin e duhur. Në shembullin e pushtetit dhe të fuqisë, njeriut i lejohej të përpiqet për t'i fituar ato. Madje, në disa raste kjo përpjekje bëhet e domosdoshme dhe detyrim fetar, si, p.sh., për vendosjen e drejtësë, për kryerjen e detyrimeve të rëndësishme shoqërore, për rikthimin e të drejtave të uzurpuara, për zbatimin e ligjeve dhe të dispozitave të Allahut etj..

Në disa rrethana, kjo përpjekje bëhet detyrim, që u takon të gjithëve. Por, nga ana tjetër, Islami e mbyll rrugën e shfrenimit të kësaj prirjeje, kur ai shndërrohet në mjet për shtypjen e të tjerëve, për dominim të padrejtë dhe për kryerjen e krimeve, siç ndodh kur u shërbehet tiranëve, regjimeve shtypëse dhe kur bashkëpunimit me ta e me to.

Ky frenim dhe kjo qëndresë përballë prirjeve të shfrenuara quhet “durim para mëkatit”

Ka edhe shembuj të tjerë. Janë ata që kanë të bëjnë me prirjen seksuale, me prirjen e dashurisë për jetën etj. Studimi i tyre hap rrugën për të kuptuar shumë çështje të rëndësishme individuale dhe shoqërore.

## **Rëndësia e durimit para mëkatit**

Duke u frymëzuar nga hadithet dhe mësimet islame që janë të pasura me dije shoqërore, mund të kuptojmë rëndësinë e madhe që ka durimi para mëkatit dhe para shfrenimit të instinkteve.

Në disa hadithe të shkurtra, secili i transmetuar në rrethana të veçanta si një mësim edukues për myslimanët luftëtarë dhe të përkushtuar në kohën e Imamëve (Paqja qoftë mbi ta!), është vënë theks i madh mbi këtë lloj durimi. Ndoshta, arsyeja është se ecja në rrugën e llojit të parë të durimit (durimi të bindja para Allahut) shoqërohet me një dëshirë dhe prirje natyrore që ekziston te njeriu, pra me dëshirën për përparim, përpjekje dhe lëvizje.

Ndërsa të mos devijosh dhe të mos u nënshtrohesh pengesave që përputhen me prirjet natyrore dhe prirjet e brendshme, pra lloji i dytë i durimit, durimi për t'u përmbajtur nga mëkati, nuk do të thotë se njeriu nuk i ka dëshirat dhe prirjet e natyrshme. Përkundrazi, ai qëndron përballë këtyre dëshirave dhe prirjeve dhe u reziston atyre.

Durimi i llojit të parë, ndonëse nga njëra anë përbën qëndresë ndaj disa prirjeve natyrore, si dashuria për rehatinë, kërkimi i lehtësisë e të ngjashme, nga ana tjetër ai

shoqërohet gjithmonë me një lloj tjetër prirjeje që e ndihmon njeriun të durojë. Edhe pse kjo prirje mund të jetë e dobët, ajo përsëri është një prirje e natyrshme.

Ndërsa lloji i dytë i durimit, pra, durimi para mëkatit, është në kundërshtim me dëshirat dhe prirjet egoiste nga të gjitha anët. Pikërisht për këtë arsye, qëndresa në këtë rast është më e vështirë dhe nga kjo pikëpamje, ai ka një pozitë më të lartë.

Gjithashtu, shohim se roli vendimtar i durimit para mëkatit ka qenë më i dukshëm në ndikimin e tij mbi ngjarjet shoqërore. Kjo mund të konsiderohet një arsye shtesë për ta vlerësuar këtë lloj durimi më lart se llojin e parë, pra, se durimin të bindja para Allahut.

## **Një shembull i durimit para mëkatit**

Për të ilustruar atë që kemi përmendur, le të ndalemi te dy figura të njohura në historinë islame dhe t'i krahasojmë ato. E para është një figurë e ndritur dhe e bukur, ndërsa e dyta është një figurë që ngjall neveri dhe përbuzje. Të dy kaluan në rrethana pothuajse identike. Madje mund të thuhet se arritën së bashku në të njëjtën udhëkryq, pasi kishin ecur për një kohë në të njëjtën rrugë. Por secili zgjodhi një drejtim tjetër. I pari, për shkak të zgjedhjes së tij, u bë një nga figurat më të mëdha dhe më të nderuara të historisë islame. Ndërsa i dyti, me zgjedhjen e tij, hyri në radhët e njerëzve më të urreyer dhe të mallkuar të historisë. Këta dy persona janë:

- Hurr ibn Jezid Er-Rijahi, i cili ishte komandant i një pjese të ushtrisë omejade dhe dërguar për t'u përballur me kryengritjen e imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!).

- Umer ibn Sa'd, i cili drejtoi ushtrinë emevite në luftën kundër imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!).

Hurri që ndër të parët që ndaloi lëvizjen e revolucionit husejnian gjatë rrugës së tij drejt Irakut. Ai dhe Umer ibn Sa'di ndodheshin në të njëjtin front dhe kishin të njëjtin drejtim politik e ushtarak. Të dy, së bashku,

kërcënonin lëvizjen e imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!) me forcën dhe autoritetin e sundimtarit të kohës së tyre. Por, kur erdhi çasti i provës dhe i zgjedhjes, rrugët e tyre u ndanë. Njëri iu dorëzua interesave, frikës dhe tundimeve të kësaj bote, ndërsa tjetri i rezistoi atyre, u pendua dhe u kthye në anën e së vërtetës. Kështu, Hurri u bë simbol i pendimit, guximit dhe durimit para mëkatit, ndërsa Umer ibn Sa'di mbeti simbol i dorëzimit para lakmive dhe interesave të kësaj bote. Në këtë mënyrë, historia i vendosi ata në dy skaje krejtësisht të kundërta.

Imam Husejni (Paqja qoftë mbi të!) qe ngritur në bazë të detyrës që kishte para Allahut, mësimave islame dhe ndjenjës së përgjegjësisë së madhe, për të dhënë një mësim praktik themelor në Islam përmes një lëvizjeje revolucionare kundër qeverisë omejade dhe sistemit të korruptuar e të degjeneruar që sundonte shoqërinë.

Meqenëse kjo lëvizje ishte një kërcënim i drejtpërdrejtë për regjimin në pushtet, qeveria mobilizoi të gjitha forcat dhe mundësitë e saj për ta shtypur atë kryengritje.

Këta dy burra - Umer ibn Sa'd dhe Hurr ibn Jezid Er-Rijahi ishin ndër forcat që u drejtuan për të shtypur atë kryengritje dhe për të eliminuar nismëtarin e saj, imam Husejn ibn Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Ata qenë si dy gurë të rëndësishëm në tabelën e lojës së kundërshtarit të vërtetë të revolucionit- khalifit uzurpator Jezid ibn Muavije. Jezidi i

lëvizte ata sipas dëshirës së tij për të arritur qëllimet e veta. Megjithatë, edhe vetë ata ishin tërhequr pas dëshirave të tyre personale dhe pas kënaqjes së instinkteve egoiste. Prandaj zbatojnë urdhrat e khalifit uzurpator.

Umer ibn Sa'di kishte ardhur në Kerbela për të luftuar imam Husejnin, i shtyrë nga etja e verbër për pushtet dhe për ta fituar atë. Meqenëse ai nuk ishte besimtar i vërtetë dhe nuk e njihte fenë në thellësinë e saj, posti i guvernatorit të Rejit ishte për të shumë më i çmuar dhe më i rëndësishëm sesa Jezidi apo vetë urdhrat e tij. Edhe Hurr ibn Jezid Er-Rijahi, kur u nis drejt Kerbelasë, ishte tërhequr pas motiveve të ngjashme.

Secili prej tyre e dinte se ajo që po bënte, ishte mëkat dhe një mosbindje e madhe para Allahut. Por prirjet njerëzore, shfrenimi i instinktit të dashurisë për pozitën dhe pushtetin, si dhe adhurimi i unit, nuk u lanë vend për të menduar për shëmtinë e veprës që po kryenin. Ata po ecnin në një rrugë, fundi i së cilës ishte të bëheshin ndër njerëzit më të ulët e më të përçmuar të historisë njerëzore dhe ndër kriminelët më të poshtër, që ka njohur njerëzimi.

Ata ishin në udhëkryq, mes dy rrugëve: Rruga e parë ishte dorëzimi para prirjeve egoiste, të cilat në këtë rast ishin shfaqur në formën e dashurisë për pozitën dhe pushtetin. Rruga e dytë ishte përmbushja e detyrës islame, duke iu bashkuar revolucionit që thërriste drejt së vërtetës nën udhëheqjen e imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!).

Ajo që mund t'i shpëtonte në ato çaste vendimtare ishte durimi- durimi përballë dëshirave dhe pasioneve që e shkatërrojnë shpirtin e njeriut, si dhe qëndrueshmëria përballë forcës shtypëse të ushtrisë së Jezidit. Pra, durimi para mëkatit dhe mosbindjes para Allahut.

Umer ibn Sa'di nuk arriti të tregonte durim në këtë kthesë vendimtare të jetës së tij. Ai nuk mundi t'u rezistonte shtysave që e çonin drejt së keqes dhe korrupsionit. Kështu, ai e lidhi qafën e vet me litarin e dashurisë për pozitën dhe pushtetin, i cili e tërhoqi drejt Xhehennemit. Ai nuk arriti të kontrollonte dobësinë dhe paaftësinë e tij të brendshme, edhe pse nga jashtë dukej i fuqishëm dhe me autoritet. Asgjë nga kjo forcë e jashtme nuk i vlejti për ta shpëtuar nga rënia në humnerë.

Hurr ibn Jezid Er-Rijahi, është në të njëjtin udhëkryq ku kishte arritur edhe Umer ibn Sa'di. Po të kishte ndjekur dëshirat e tij dhe t'u ishte dorëzuar atyre, po t'i kishte zbatuar urdhrat që i vinin nga sundimtari dhe të mos i kishte dëgjuar thirrjet zgjimtare të arsyës së tij, po të mashtronte veten se ishte, thjesht një ushtar që zbatonte urdhra dhe prandaj ishte i justifikuar, atëherë, pa dyshim, rruga drejt posteve dhe pozitave do të ishte e hapur për të. Është e vërtetë se atij nuk i ishte premtuar qeverisja e Rejit, siç ishte rasti me Umer ibn Sa'din, por ishte pothuajse e sigurt se do t'i jepej një post tjetër i rëndësishëm.

Litari i lakmisë dhe i pasioneve të korruptuara po i rrethonte edhe atij qafën. Këto dëshira e tërhiqnin edhe atë drejt humnerës dhe zjarrit të Xhehenemit. Atje ai qëndroi mes dy kampeve:

I pari ishte kampi që të çonte menjëherë drejt Xhenetit, aty ku buron burimi i pastër i Islamit autentik dhe ku shfaqet madhështia e shpirtit njerëzor.

I dyti ishte kampi që të çonte me shpejtësi drejt Xhehenemit- kampi jezidian, simbol i rënies morale dhe i poshtërimit, i gënjeshtërs dhe i mashtrimit, si dhe kështjella e injorancës (xhahilijetit) që sundonte shoqërinë në emër të Islamit. Këto ishin dy kampet që qëndronin përballë njëri-tjetrit.

Është e vërtetë se prirjet e devijuara dhe rënia e kishin sjellë Hurrin deri në atë vend. Por papritur u shfaq një forcë heroike dhe një vetëdijesim i fuqishëm që nxitoi ta shpëtonte. Në çastin kur ai ishte pranë humnerës, kjo forcë arriti të këpuste litarin që i ishte mbështjellë rreth qafës. Ai shpëtoi duke u rezistuar atyre shtysave dhe lakmive përmes durimit dhe me një kapërcim kaloi nga rrethi i Xhehenemit në horizontin e Xhenetit. Në këto ngjarje, e në këto shembuj, shihet shumë qartë për ata që e studiojnë historinë me thellësi, roli jashtëzakonisht i rëndësishëm i durimit para mëkatit.

Ky durim ka luajtur rol vendimtar në formimin e fronteve të mëdha të së vërtetës dhe të së pavërtetës, të cilat përbëjnë në fund të fundit interpretimin më të vërtetë të historisë së njerëzimit.

## **Shembuj të tjerë**

Për të kuptuar dhe studiuar më mirë rolin e rëndësishëm të durimit para mëkatit, duhen parë shembuj të tjerë e të sjellim në mendje forma të ndryshme devijimesh dhe mëkatesh të mëdha: Një grusht që dëshiron të bjerë mbi kokën e një të pafajshmi, pa asnjë pengesë ajo ndalesë është një nga rastet ku kërkohet durimi.

Shtysat e zemërimit, të fanatizmit, mendjemadhësisë dhe dëshirës për t'i dëmtuar të tjerët kanë një forcë të veçantë tërheqëse, për ta bërë dorën ta godasë atë të pafajshmin. Këtu, durim do të thotë t'i rezistosh kësaj force dhe të mos tërhiqesh pas saj për t'u bërë padrejtësi të tjerëve. Po ashtu, dëshira për grumbullimin e pasurisë mund të bëhet shkak devijimi që e shtyn njeriun drejt krimeve dhe mëkateve. Në këtë rast, durimi nënkupton rezistencën para kësaj prirjeje dhe heqjen dorë nga fitimet e përfitimet që e çojnë njeriun drejt mëkatit. Edhe lakmitë seksuale janë ndër prirjet më të fuqishme, aq sa mund të mposhtin edhe njerëzit e fortë dhe heronjtë. Pikërisht për shkak të kësaj force joshëse, armiqtë e njerëzimit i kanë përdorur shpesh

ato si mjet për të korruptuar njerëzit me shpirt të fortë dhe për t'i tërhequr drejt rënies morale dhe degjenerimit. Këtu, durim do të thotë t'u rezistosh këtyre dëshirave dhe pasioneve që e shtyjnë njeriun drejt mëkatit.

Vijmë te frika. Frika është një instinkt themelor te njeriut. Mirëpo, në disa raste, si në ngjarjen e Kerbelasë, ajo mund të shndërrohet në një faktor negativ që e çon njeriun drejt poshtërimit, nënshtrimit dhe krimeve të mëdha.

Sa shumë njerëz të dobët janë dorëzuar nga frika për jetën, pasurinë, postet ose fëmijët e tyre. Dhe, për shkak të frikës kanë kryer krimet më të shëmtuara dhe e kanë ulur dinjitetin e tyre njerëzor deri në atë shkallë, sa janë bërë vegla që lëvizin pa vullnet dhe pa vetëdije. Prandaj, rezistenca ndaj këtyre prirjeve të këqija dhe shkatërruese është një formë tjetër e durimit.

Pasi vumë bazat për të rrokur koncepti për durimin para mëkatit, mund të kalojmë te transmetimet e ardhura nga imamët e pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!), për të nxjerrë prej tyre mësim dhe urtësi.

Është transmetuar nga El-Esbag se Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: *“Durimi është dy llojesh: një durim gjatë fatkeqësisë, i cili është i*

*mirë dhe i bukur; por më e bukur se ai është durimi para asaj që Allahu ta ka ndaluar.”<sup>5</sup>*

(Për durimin gjatë fatkeqësisë do të paraqesim më pas një ndarje tjetër.)

Transmetimi i dytë është nga Ebu Abdullahu, imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Do të vijë te njerëzit një kohë, kur pushteti nuk do të arrihet veçse me vrasje dhe tirani, pasuria nuk do të fitohet, veçse me grabitje dhe koprraci dhe dashuria nuk do të fitohet, veçse duke nxjerrë fenë nga jeta dhe duke ndjekur epshet. Kush e arrin atë kohë dhe duron varfërinë, ndërkohë që ka mundësi të bëhet i pasur, duron urrejtjen, ndërkohë që ka mundësi të fitojë dashurinë e njerëzve dhe duron poshtërimin, ndërkohë që ka mundësi të arrijë lavdinë, Allahu do t’i japë shpërblimin e pesëdhjetë besnikëve të singertë që më kanë besuar mua.”<sup>6</sup>*

Ky hadith, të cilin imam Sadiku e përcjell nga i Dërguari i Allahut, flet për të ardhmen e ymetit islam me fjalët: *“Do të vijë një kohë...”* Dhe shumë shpejt erdhi ajo kohë e përgjakshme, kur Muavija dhe i biri sunduan mbi ymetin islam me force, tirani, vrasje, derdhje gjaku.

Pasuria filloi të fitohej duke grabitur të drejtat e të shtypurve, duke cenuar shtresat e dobëta, duke shfrytëzuar

---

<sup>5</sup> “El-Kafij”, vëll. 2, f. 90.

<sup>6</sup> “El-Kafij”, vëll. 2, f. 92.

masat e njerëzve, duke mos përmbushur detyrimet financiare dhe duke mos u kujdesur për nevojat e të varfërve.

Prirja e zakonshme e shoqërisë islame u bë e tillë që pasuria të mos shpërndahej në mënyrë të drejtë mes njerëzve; madje, pa padrejtësi nuk mund të siguroheshin pasuria dhe kapitali. Kështu, pasuria dhe shtimi i pasurisë u mbështetën te privimi dhe shtypja e të tjerëve. Dhe, siç e dimë, kjo u bë realitet.

Sa i përket fitimit të dashurisë dhe popullsisë, ato nuk mund të arriheshin më, përveçse duke larguar shpirtin e fesë nga jeta dhe duke ndjekur dëshirat e unit. Kjo bëhej përmes lajkatimit, gënjeshtërisë, hipokrizisë dhe mashtrimit. Përmes fshehjes së të metave, që duhej të denoncoheshin me zë të lartë; përmes shtrembërimit të së vërtetës dhe braktisjes së urdhërimit për të mirën dhe ndalimin e së keqes. Pikërisht me këto metoda sundimtarët dhe udhëheqësit e korruptuar fitonin zemrat e njerëzve.

Nëse njeriu do t'u përmbahej përgjegjësi të tij islame, ai nuk do ta përdorte gënjeshtërinë dhe lajkatimin, por do t'i shpallte hapur devijimet dhe shtrembërimet që ekzistojnë në shoqëri ose brenda shtresës së pushtetarëve dhe të fuqishmëve. Ai do t'i sqaronte të vërtetat, nuk do ta mashtronte popullin me premtime të rreme e të zbrazëta, nuk do të pajtohej me gjendjen e keqe ekzistuese dhe, me fjalë të hidhura që janë ilaç për shoqërinë dhe thikë e

mprehtë për sundimtarët tiranë, do të nxirrte në pah të gjitha të këqijat dhe devijimet. Ky njeri, në shoqërinë, për të cilën flet i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), do të humbiste vlerën në sytë e njerëzve dhe do të privohej nga mbështetja dhe simpatia e tyre.

Kjo fjali, e mbushur me domethënie, tregon rënien dhe degradimin e nivelit të mendimit dhe të vetëdijes së njerëzve, rënien e vlerave islame në kriteret e një shoqërie të degraduar, përmbysjen e normave dhe të standardeve të përgjithshme, si dhe lindjen e rrymave devijuese në jetën e njerëzve. Dhe është shumë e qartë se rënia në një gjendjeje të tillë e një populli, mënyra dhe forma e jetesës së të cilit në fillim mbështetej mbi vlera të mirëfillta, dhe në një popull, rrugëtimi i të cilit ecte mbi binarët e mendimit dhe të metodës islame, nuk mund të ketë ardhur veçse nga duart e tiranëve dhe të sunduesve despotikë, si dhe nëpërmjet planeve të tyre të përgatitura me përpikëri.

Duke u mbështetur në këto trajtime, mund të kuptohen shumë prej ngjarjeve politike të sajara dhe tragjike në historinë e Islamit:

Kur uleshin njerëzit në praninë e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), shihnin në fytyrën dhe në sjelljen e këtij Imami të madh veçse paralajmërime për rrezikun e mëkateve dhe të devijimeve, si dhe ndëshkimin e mëkatarit

dhe të të devijuarit me kamxhikun e zemërimit dhe ndëshkimit nga Allahu.

Madje, edhe i vëllai, Akili, kur kërkoi prej tij një sasi pasurie që nuk i takonte, pa në dorën e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) një hekur të nxehur dhe dëgjoi prej tij fjalë qortimi e vërejtjeje. Ndërsa në anën tjetër, shohim se po ky Akil ose të tjerë si ai, kur shkonin te Muavija për të kërkuar pasuri, priteshin me buzëqeshje, me fytyrë të qeshur dhe me qese të mbushura me ar, pa llogari e pa kufi. Kjo ishte pikërisht metoda e sundimtarëve të devijuar për të fituar zemrat e njerëzve: me pasuri, favore, lajka dhe mashtrime, e jo me të vërtetën, drejtësinë dhe përgjegjësinë fetare.

Prandaj ishte krejt e natyrshme që ata njerëz, të cilët nuk udhëhiqeshin nga logjika dhe mendimi i drejtë islam, të parapëlqenin dashurinë për Muavijen dhe jo dashurinë për imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!), të cilin duhet ta pranonin dhe ta mbështesnin.

Nuk duhet të mendojmë se Muavija nuk ishte i dashur nga bashkëkohësit e tij në Kufe dhe Medine. Madje, edhe shumë prej atyre që kishin jetuar nën udhëheqjen e Prijësit të besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), dhe që ishin njohur me mësimet autentike të Islamit, si dhe shumë të tjerë nëpër viset islame, pavarësisht shtypjes ideologjike të regjimit emevit dhe të propagandës së përhapur nga Muavija, e konsideronin atë një person të respektuar dhe të denjë.

Madje, ata e quanin “daja i besimtarëve” (*khalul-mu'minin*). Në këtë ndikonte edhe natyra e tij mashtruese dhe zgjuarsia e tij politike. Për këtë arsye, kishte shumë njerëz që e shihnin si një figurë të fortë dhe të dashur. Muavija kishte ndjekur një metodë të veçantë me krerët e fiseve dhe personalitetet me ndikim. Ai i tërhiqte vazhdimisht me poste, privilegje dhe dhurata të shumta materiale, ndërsa u jepte pushtet të plotë mbi njerëzit e pafajshëm e të pambrojtur.

Të gjitha këto metoda luajtën një rol të madh në çuarjen e ymetit islam në gjendjen e mjerueshme që u përshkrua më sipër. Po ashtu, ata që përfitonin nga kjo gjendje, për t’ia kthyer “nderin” mirëbërësit të tyre dhe për të ruajtur privilegjet e veta, i lëshonin gjuhët në përlavdërime e himne për Muavijen, duke ua paraqitur njerëzve veset e tij si virtyte dhe të metat e tij si cilësi të mira.

Atëherë, si do të dukej e ardhmja e botës islame nga këndvështrimi i epokës së Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)? Dhe përballë kësaj gjendjeje dhe këtij sistemi të korruptuar që do të përfushej, cila do të ishte detyra e njerëzve?

Kthehemi te hadithi i transmetuar nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), për të gjetur përgjigjen e kësaj pyetjeje. Hadithi është pikërisht përgjigjja që përfshihet te kuptimi për durimin: “*Kush e arrin atë kohë...*” Domethënë, kush përballet me një gjendje të tillë si ajo që u përmend në

hadith, qoftë në periudhën afër epokës së Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) apo në kohë më të largëta. *“Dhe duron varfërinë, ndërkohë që ka mundësi të bëhet i pasur...”*, që do të thotë se ai i reziston etjes së shfrenuar për grumbullimin e pasurisë dhe mirëqenien materiale, në një kohë kur ka mundësi të bëhet si njerëzit e tjerë, të cilët qëndrojnë vetëm si spektatorë përballë ngjarjeve dhe padrejtësive të kohës së tyre. Këta- njerëzit e tjerë ndjekin rrugën e zakonshme, që çon drejt pasurisë, duke pranuar poshtërimin dhe nënshtrimin, duke kryer krime, duke i lidhur virtytet me zinxhirë e pranga dhe duke mos u interesuar për besimin e drejtë. E gjithë kjo bëhet në këmbim të pasurisë së tyre. Ndërsa mijëra njerëz rrojnë në varfëri, ndërsa turma të mëdha njerëzish të uritur nuk gjejnë as një kafshatë për të mbajtur veten gjallë, i pasuri shijon ushqime të shtrenjta.

*“Duron varfërinë, ndërkohë që ka mundësi të bëhet i pasur.”* Domethënë: ai e largon shikimin nga të gjitha këto mundësi dhe nuk i zgjedh ato, sepse çmimi është humbja e dinjitetit dhe e drejtësisë.

*“Dhe duron urrejtjen, ndërkohë që ka mundësi të fitojë dashurinë.”* Kjo do të thotë: Ai duron të jetë i refuzuar nga njerëzit ose të ketë një emër të keq në shoqëri, sepse i reziston dëshirës për famë, pozitë dhe përkrahje.

Ai ka mundësi të fitojë simpatinë e turmave të paditura dhe të zyrtarëve të korruptuar përmes lavdërimit

të tyre, lajkatimit, mashtrimit të njerëzve të thjeshtë, heshtjes para së vërtetës dhe braktisjes së urdhërimit për të mirë dhe ndalimit të së keqes. Por ai nuk e bën këtë.

Ai e di se ecja në rrugën e përmbushjes së detyrës dhe mbajtjes së përgjegjësisë para Allahut e njerëzve do ta bëjë të bjerë nga sytë e njerëzve dhe do ta vendosë në mesin e atyre që kundërshtohen nga pushtetarët tiranë. Ai e di se nderi dhe reputacioni i tij do të bëhen objekt sulmesh dhe akuzash nga mendjemëdhenjtë dhe arrogantët.

*“Dhe duron poshtërimin, ndërkohë që ka mundësi të arrijë lavdinë.”* Domethënë: Ai parapëlqen të jetë në shtresat më të ulëta të shoqërisë, i privuar nga postet e larta dhe gradat që do t'i siguronin një jetë të rehatshme, edhe pse mund t'i arrinte ato duke kryer padrejtësi dhe mëkate. Por ai nuk e bën këtë.

Për këtë arsye hadithi përfundon: *“Allahu do t'i japë shpërblimin e pesëdhjetë besnikëve të singertë që më kanë besuar mua.”* Ky hadith madhështor, i transmetuar nga një burim i lartë dhe me një vlerë e pozitive të jashtëzakonshme, për shkak të mësimave shumë të rëndësishme dhe të thella që përmban në fushën e një prej çështjeve më të rëndësishme shoqërore, na jep kuptimin dhe vlerën e këtij lloji durimi-durimit para mëkatit.

Jeta e njeriut është gjithmonë e ekspozuar ndaj ngjarjeve, sprovave dhe fatkeqësive të vështira e të

dhembshme. Kjo është një nga veçoritë e pashmangshme të jetës së njeriut në këtë tokë. Për këtë ka një thënie e njohur e Prijësit të besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Ai e përshkruan jetën e kësaj bote të ruajtur me sprova. Dhembjet, humbjet fizike e materiale, humbja e të dashurve, privimet dhe lloje të tjera fatkeqësish e kanë shoqëruar historinë e njerëzimit edhe për ata që kanë jetuar në mirëqenie, edhe për të tjerët.

Përballë këtyre sprovave, që i ndodhin njeriut pa dëshirën dhe vullnetin e tij, shfaqet realiteti i karakterit të njerëzve dhe i veprave. Disa humbin aftësinë për të qëndruar të fortë përballë fatkeqësisë dhe pësojnë disfatë shpirtërore. Të tjerë e durojnë sprovën, ose e konsiderojnë atë një gjë të natyrshme, duke e lehtësuar peshën e saj dhe duke dalë prej saj të papërkulur e me kokën lart, siç thotë poeti Rudeki: “Madhështia dhe fisnikëria e njeriut provohen në kohët e fatkeqësisë dhe të sprovës.”

Sa u përket pikëllimit, dëshpërimit dhe ankesave të pakontrolluara- ato janë mënyra të të dobëtëve dhe e zemrave të brishta. Janë prirje e natyrshme e njeriut. Njeriu krijon gjendje emocionale që mund ta pushtojnë atë. Njeriu ankohet, rënkon, bërtet, reagon në mënyrë të pakontrolluar etj., kur e godet një fatkeqësi. Këtu, durimi përballë fatkeqësisë do të thotë nënshtrim dhe kënaqësi me caktimin e Zotit, përballë trazimit emocional. Durimtari në fatkeqësi është ai që nuk e humbet forcën shpirtërore dhe

personalitetin e tij njerëzor dhe nuk rrëmbehet nga ngjarjet që e godasin.

Fatkeqësia nuk e dobëson durimtarin, nuk ia paralizon vendosmërinë dhe nuk e ndalon nga përpjekja dhe lufta në rrugën për qëllimin e lartë të jetës. Ky lloj durimi është, gjithashtu, shumë i lavdëruar, ashtu siç ka ardhur në hadith: *“Durimi në fatkeqësi është i mirë dhe i bukur.”*

Po të ndodhte që njeriu, që duhet të ecë në rrugën për arritjen e qëllimit të tij, të humbiste vendosmërinë dhe një pjesë të energjisë së tij shpirtërore, sa herë të përballej me një ngjarje të dhembshme, atëherë nuk do të ishte e arsyeshme të pritej prej tij që të ruante bazën dhe rezervën shpirtërore të nevojshme për ta përshkuar këtë rrugë. Prandaj, qëndresa ndaj prirjeve që e bëjnë njeriun të dobët përballë fatkeqësive është faktori që ruan vendosmërinë dhe gjallërinë shpirtërore, duke mos lejuar që ato të humbin a të shkatërrohen. Më e rëndësishmja dhe më e vlefshme është se vetë kjo qëndresë është një ushtrim dhe stërvitje e vështirë. Por, ajo shumë e dobishme, sepse forcon vullnetin dhe qëndrueshmërinë e njeriut. Pa këtë forcë të brendshme është e pamundur të përshkohet kjo rrugë e vështirë për arritjen e qëllimit, veçanërisht kur njeriu përballlet me prova dhe fatkeqësi.

Prandaj, durimi në fatkeqësi ka dy dobi shumë të rëndësishme:

**E para:** Ruhet energjia shpirtërore, mbi të cilat mbështeten veprat dhe përpjekjet e dobishme.

**E dyta:** Forcohet vullneti dhe vendosmëria, të cilat e shtyjnë njeriun drejt veprimit dhe i japin atij durim e qëndrueshmëri përballë fatkeqësive të papritura. Pikërisht për këtë arsye, ky lloj durimi është theksuar dhe është nxitur në mënyrë të jashtëzakonshme nga eulijatë dhe imamët e fesë, për shkak të rolit të tij ndërtues dhe të veçantë në formimin e personalitetit të njeriut.

Kjo filozofi e thellë pasqyrohet në këto dy hadithe:

Hadithi i parë: Është transmetuar nga Ebu Abdullahu ose Ebu Xha'ferri (Paqja qoftë mbi ta!) se ka thënë: *"Ai që nuk përgatit durimin për fatkeqësitë e kohës, do të mbetet i paaftë."*<sup>7</sup>

Hadithi i dytë: Është transmetuar nga Ebu Abdullahu, imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: *"Me të vërtetë, njeriu mund të mos ketë arritur një gradë tek Allahu me veprat e tij. Atëherë Allahu e sprovon në trupin e tij, ose në pasurinë e tij, ose në fëmijët e tij. Nëse ai tregohet i durueshëm, Allahu e çon në atë gradë."*<sup>8</sup>

Nga ky hadith shihet qartë roli I madh I durimit në lartësimin e njeriut. Në këtë kontekst, po përmendim një

---

<sup>7</sup> "El-Kafij", vëll. 2, f. 93.

<sup>8</sup> "Sefinetul-Bihar", vëll. 2, f. 19.

ngjarje që lidhet me Uthman ibn Madh'unin, një nga myslimanët e parë, prej atyre që patën përparësi dhe merita të mëdha në historinë e Islamit të hershëm, si dhe një nga ata që emigruan në Habeshe dhe më pas, në Medine. Ai humbi djalin e tij të ri. Fatkeqësia e goditi aq rëndë, sa që vendosi të mbyllej në shtëpi, të kalonte pjesën e mbetur të jetës në adhurim dhe të largohej nga të gjitha veprimtaritë dhe angazhimet shoqërore. Ajo ndikoi tek ai deri në atë masë, sa që e gjithë jeta humbi kuptimin për të.

Kur i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e mori vesh këtë, shkoi tek ai dhe e këshilloi e i tha: “Nuk ka murgëri (*rrahbanijeh*) në Islam.” Po. Në Islam nuk lejohet veçimi nga shoqëria, braktisja e jetës dhe kalimi i gjithë kohës vetëm me adhurime individuale.

Pastaj i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: “Murgëria e umetit tim është xhihadi.” Pra, duhet durimi para fatkeqësive, që ndodhin pa vullnetin e njeriut edhe durim do të thotë: të përballosh sprovën pa humbur gjallërinë, energjinë dhe rolin aktiv në jetë, të kapërcesh tronditjen që shkakton ngjarja e dhembshme dhe të vazhdosh rrugën e punës, të përpjekjeve dhe të misionit kryesor të jetës. Në këtë mënyrë, fatkeqësia nuk e paralizon njeriun, por bëhet shkak për forcimin dhe pjekurinë e tij shpirtërore.

## **Durimi para sprovave të zgjedhura me vetëdije**

Ka një lloj durimi edhe më të rëndësishëm se durimi para fatkeqësive të papritura. Është durimi kur njeriu ecën drejt qëllimit të tij me vetëdije dhe duron sprovat e vështirësitë që patjetër hasen në atë rrugë, pa u ndalur dhe pa hequr dorë nga vazhdimi i saj.

Kur analizojmë thellë atë që studiuesit kanë shkruar rreth ngjarjeve historike që lidhen me popujt dhe shoqëritë, arrijmë në përfundimin se qëllimet e larta njerëzore e mbi të gjitha, qëllimet e profetëve, kanë qenë gjithmonë në kundërshtim dhe përplasje me interesat e klasave sunduese e shtypëse. Për këtë arsye, flamurtarët e këtyre idealeve kanë qenë vazhdimisht në përballje me krerët e këtyre klasave.

Kur'ani i Shenjtë i ka përmendur në shumë ajete përballjet ndërmjet profetëve me tiranët, sundimtarët e padrejtë dhe të pasurve arrogantë dhe kjo gjendje, e cila është e pashmangshme në një lëvizje të tillë, sjell domosdoshmërisht lloje të ndryshme sprovash, vuajtjesh dhe mundimesh për ata që ecin në rrugën e së vërtetës,

thërrasin për drejtësi e barazi, ndjekin profetët dhe i përmbahen metodës së tyre.

Për t'i përgatitur besimtarët paraprakisht për këto vështirësi, Kur'ani ua bën të qarta rreziqet dhe sprovat:

﴿لَتَبْلُوَنَّ فِي أَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ وَلَتَسْمَعَنَّ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَمِنَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا أَذًى كَثِيرًا ۖ وَإِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ﴾

**“Ju do të sprovoheni patjetër në pasuritë dhe në vetet tuaja, dhe do të dëgjoni shumë fyerje e shqetësime nga ata, që u është dhënë Libri para jush dhe nga idhujtarët. Por, nëse tregoheni të durueshëm dhe të devotshëm, atëherë kjo është prej punëve që kërkon vendosmëri të madhe.”<sup>9</sup>**

Dhe ata që dëshirojnë një jetë të mbështetur në besim, që duan ta bëjnë adhurimin e vërtetë para Allahut dhe të përmbushin detyrimet e përgjegjësitë fetare para Allahut, do të përballen patjetër me lëndime, presione, përndjekje dhe vështirësi të llojeve të ndryshme. Ata do ta shohin me sytë e tyre këtë paralajmërim kur'anor. Natyrisht, sa më e lartë të jetë grada e njeriut në besim dhe në vepra, aq më të mëdha do të jenë sprovat që do ta godasin dhe aq më shumë do të ketë nevojë për forcë, qëndrueshmëri dhe durim. Imam Xhafer Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Njerëzit që sprovohen më rëndë janë profetët- pastaj- ata

<sup>9</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 186.

që u ngjajnë më shumë profetëve, e pastaj- ata që u ngjajnë pas këtyre.”

Durimi para kësaj lloj sprove nuk është si durimi para fatkeqësive të papritura dhe të pashmangshme. Në këtë rast, njeriu nuk është i detyruar domosdoshmërisht t’i përballojë ato. Ai mundet, kur të dëshirojë të kthehet në një jetë të lehtë e të rehatshme dhe ta shmangë përballjen me vështirësitë.

Mirëpo, ai që pranon me vetëdije të ballafaqohet me këto sprova të pashmangshme, është pikërisht ai që ecën drejt qëllimit të lartë dhe përfundimtar. Ndërsa ai që zgjedh sigurinë dhe rehatinë, që qëndron i mbyllur në shtëpi dhe nuk hedh asnjë hap jashtë saj, që nuk pranon mundimin e udhëtimit dhe heq dorë nga të gjitha dobitë që sjell lëvizja e përpjekja, mund ta ruajë veten gjatë gjithë jetës nga rënia prej malit, nga kafshët grabitqare, nga kusarët e rrugës dhe nga qindra rreziqe të tjera të udhëtimit. Po kështu është edhe njeriu indiferent, ai që nuk ndien asnjë përgjegjësi në vetvete dhe nuk sheh një qëllim të lartë për jetën e tij. Ky njeri nuk hedh asnjë hap në rrugën që çon drejt synimit të vërtetë. Ai dëshiron që jeta e tij të mbetet pa ngjarje, pa shqetësime dhe pa sprova.

Siç thotë poeti Sa’di: *Në det ka dobi të panumërta, por ai që kërkon vetëm siguri, mbetet në breg.*

Pra, sprovat dhe vështirësitë në rrugën e profetëve janë zgjedhore, të pranuara me vetëdije. Ata që përballen me to janë pasuesit e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), për të cilët ai ka thënë: “Dhe futu në vështirësi për hir të së vërtetës.” Dhe ata janë njerëzit që iu përgjigjën me sinjeritet thirrjes së profetëve dhe qëndruan të palëkundur në atë rrugë.

Durimi në Rrugën e së Vërtetës është një nga llojet më të rëndësishme, sepse ai zbulon thelbin dhe vlerën e vërtetë të njeriut. Ky durim të bën të pranosh sprovën dhe të mos pendohesh për atë që të ka goditur në Rrugën e Allahut.

Khabbab ibn El-Erth që një prej myslimanëve që sakrifikuan dhe ndër të parët që pranuan Islamin. Për shkak të besimit të tij, ai humbi pjesën më të madhe të pasurisë dhe të zotërimeve të veta. Ai vetë tregon: Shkova tek i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ai ishte mbështetur mbi mantelin (rrobën) e tij në hijen e Qabes. Ne kishim provuar mundime të rënda nga idhujtarët. I thashë: ‘O i Dërguari i Allahut! A nuk luteni për ne?’ Ai u ngrit dhe me fytyrë të skuqur, tha: “Ata që kanë qenë para jush, njërit prej atyre i krihej trupi me krehër prej hekuri, derisa mishi dhe nervat i ndaheshin nga kockat; por kjo nuk e largonte nga feja e tij. Tjetrit i vihej sharra mbi mesin e kokës dhe i ndahej në dy pjesë; por kjo nuk e largonte nga feja e tij. Beto hem në Allahun, Allahu do ta kryejë këtë punë (Islamin), dhe udhëtari të ecë nga San’aja

në Hadramaut pa pasur frikë nga askush, përveçse nga Allahut dhe nga ujku për kopenë e tij.”<sup>10</sup>

Me fjalë të tilla të zjarrita dhe frymëzuese, i Dërguari i Allahut ndizte në zemrat e besimtarëve flakën e qëndresës dhe të vullnetit të hekurt, i nxiste ata të bënin durim dhe të qëndronin të palëkundur përballë sprovave në rrugën e besimit.

Mund të ndodhë që njeriu të durojë kur kryen detyrimet fetare, ose kur largohet nga mëkatet dhe kështu, llogaritet ndër besimtarët që ecin në rrugën e Islamit. Por ai mund të mos i përballojë sprovat dhe vështirësitë që janë të pashmangshme në këtë rrugë. Si pasojë, mund të goditet nga dobësia shpirtërore dhe ideologjike, mund ta kaplojë dëshpërimi dhe zhgënjimi dhe ndalet dhe nuk arrin të synimi përfundimtar. Madje, mund të kthehet prapa duke lënë përgjysmë një pjesë të detyrimeve dhe përgjegjësi të tij.

Kjo do të thotë që arritja e qëllimit dhe vazhdimi i rrugëtimit varen nga durimi, nga durimi para sprovave të zgjedhura me vetëdije në Rrugën e Allahut. Për arsye të rëndësisë së madhe të durimit dhe rolit themelor që ai luan në jetën e njeriut, Kur’ani i Shenjtë e ka theksuar atë në

---

<sup>10</sup> “Biharul-Enuar”, vëll. 18, f. 220.

shumë ajete, me qëllim që të krijojë te njeriu bazën e nevojshme për qëndresë.

Një nga mënyrat që na ndihmon përballë sprovave të zgjedhura (janë sprovat, që njeriu i pranon me vetëdije në Rugën e Allahut), është përmendja dhe kujtimi i sprovave të detyruara (të pashmangshme).

Allahu i Madhëruar, për ta bërë më të lehtë pranimin e vdekjes për besimtarët, na kujton në Kur'an se ajo (vdekja) është fundi i pashmangshëm i çdo njeriu. Ai që nuk vdes në fushën e betejës, do të vdesë në shtëpinë e tij ose në shtratin e tij. Jeta dhe vdekja janë në dorën e Allahut. Por vdekja në Rugën e Allahut është vepër, për të cilën njeriu shpërblehet me sevap dhe mëshirë. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَمَا كَانَ لِنَفْسٍ أَنْ تَمُوتَ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ كِتَابًا مُؤَجَّلًا ۚ وَمَنْ يُرِدْ ثَوَابَ الدُّنْيَا نُؤْتِهِ مِنْهَا وَمَنْ يُرِدْ ثَوَابَ الْآخِرَةِ نُؤْتِهِ مِنْهَا ۚ وَسَنَجْزِي الشَّاكِرِينَ﴾

**“Asnjë njeti nuk mund të vdesë, veçse me lejen e Allahut, në kohën e caktuar. Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, Ne do t’i japim prej saj; e, kush dëshiron shpërblimin e Ahiretit, Ne do t’i japim prej tij. Dhe Ne do t’i shpërblejmë mirënjohësit.”<sup>11</sup>**

Po ashtu thotë:

---

<sup>11</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 145.

﴿وَلَيْنَ قُتِلْتُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَوْ مُتُّمْ لَمَغْفِرَةٌ مِنَ اللَّهِ وَرَحْمَةٌ خَيْرٌ مِمَّا يَجْمَعُونَ﴾

**“Dhe nëse vriteni ose vdisni në Rrugën e Allahut, falja dhe mëshira e Allahut janë më të mira se gjithçka që ata grumbullojnë.”<sup>12</sup>**

Dhe:

﴿الَّذِينَ قَالُوا لِإِخْوَانِهِمْ وَقَعَدُوا لَوْ أَطَاعُونَا مَا قُتِلُوا قُلْ فَادْرَءُوا عَنْ أَنْفُسِكُمُ الْمَوْتَ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ﴾ وَلَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ قُتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَمْوَاتًا ۚ بَلْ أَحْيَاءٌ عِنْدَ رَبِّهِمْ يُرْزَقُونَ

**“Ata që u thanë vëllezërve të tyre, ndërsa vetë qëndruan mënjanë: ‘Sikur të na kishin dëgjuar, nuk do të ishin vrarë’, thuaju: ‘Atëherë largojeni vdekjen nga vetja juaj, nëse jeni të sinqertë.’ Dhe mos i konsideroni të vdekur ata që janë vrarë në Rrugën e Allahut. Ata janë të gjallë te Zoti i tyre dhe furnizohen.”<sup>13</sup>**

Ka edhe një mënyrë tjetër që përmendet në ajetet 139 dhe 140 të sures Ali Imran, e cila e shtyn njeriun përpara dhe e bën atë të pranojë me kënaqësi sprovat që has në këtë rrugë. Allahu thotë:

﴿وَلَا تَهِنُوا وَلَا تَحْزَنُوا وَأَنْتُمُ الْأَعْلَوْنَ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ﴾

<sup>12</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 157.

<sup>13</sup> Sure “Ali Imran”, ajetet 168–169.

**“Mos u ligështoni dhe mos u trishtoni, sepse ju do të jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë.”<sup>14</sup>**

Dhe:

﴿إِنْ يَمْسَسْكُمْ قَرْحٌ فَقَدْ مَسَّ الْقَوْمَ قَرْحٌ مِثْلُهُ ۚ وَتِلْكَ الْأَيَّامُ نُدَاوِلُهَا بَيْنَ النَّاسِ﴾

**“Nëse ju ka goditur një plagë, edhe atë popull e ka goditur një plagë e ngjashme. Këto ditë Ne i ndërrojmë mes njerëzve...”**

Këto ajete i mësojnë besimtarit se vështirësitë dhe sprovat janë pjesë e natyrshme e jetës dhe e rrugës për të vërtetën. Prandaj, ai nuk duhet të dorëzohet para tyre, por të qëndrojë i fortë, me durim, me shpresë dhe me besim tek Allahu.

Ka edhe ajete të tjera që tregojnë këtë mënyrë të edukimit dhe të forcimit të shpirtit. Në ajetin 146 të së njëjtës sures “Ali Imran” përmenden gjendjet e njerëzve të mëparshëm, përpjekjet e tyre në Rrugën e Allahut, durimi dhe përballimi i sprovave të zgjedhura (të pranuar me vetëdije):

﴿وَكَايْنٍ مِنْ نَبِيِّ قَاتَلَ مَعَهُ رِثْوَنَ كَثِيرٍ فَمَا وَهَنُوا لِمَا أَصَابَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَمَا ضَعُفُوا وَمَا اسْتَكَانُوا ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الصَّابِرِينَ﴾

<sup>14</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 139.

**“Sa shumë profetë kanë pasur pranë vetes shumë njerëz të devotshëm, të cilët luftuan bashkë me ta. Ata nuk u dobësuan për shkak të asaj që i goditi në Rrugën e Allahut, nuk u ligështuan dhe nuk u përulën. Allahu i do durimtarët.”<sup>15</sup>**

Përveç këtij ajeti, ka edhe shumë ajete të tjera që kanë folur për këto ngjarje dhe përmes tyre i kanë nxitur njerëzit të vazhdojnë në rrugën e profetëve.

Ky lloj durimi para këtyre sprovave, është shumë i vështirë dhe kërkon vullnet të fortë dhe besim të palëkundur. Njëherësh luan rol të jashtëzakonshëm në krijimin e atij vullneti të fortë dhe atij besimi të qëndrueshëm. Mbi të gjitha, ai ndihmon në ndërtimin dhe krijimin e Xhennetit shoqëror të Islamit.

Për këtë arsye, ky durim është nxitur dhe urdhëruar në shumë ajete të Kur’anit dhe në shumë hadithe nga Imamët e udhëzimit (Paqja qoftë mbi ta!).

Hulumtimi ynë mbështetet më shumë në transmetimet (hadithet). Po përmendim një transmetim që përfshin durimin përballë çdolloj sprove dhe fatkeqësie.

Transmetohet nga Ebu Basiri: E dëgjova Ebu Abdullahun, imam Xha’ferr Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) që tha: *“I liri është i lirë në të gjitha gjendjet e tij. Nëse e godet një*

---

<sup>15</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 146.

*fatkeqësi, ai bën durim para saj. Edhe nëse sprovat bien mbi të njëra pas tjetrës, ato nuk e thyejnë atë. Edhe nëse robërohet, mposhtet dhe i zëvendësohet lehtësia me vështirësi, ai mbetet i lirë. Ashtu si Jusufi, i singerti dhe besniku, të cilit nuk iu dëmtua liria e tij shpirtërore, edhe pse u skllavërua, u shtyp dhe u burgos...”<sup>16</sup>*

Ky hadith tregon se liria e vërtetë e njeriut nuk varet nga rrethanat e jashtme, por nga forca e shpirtit, besimi dhe durimi i tij. Njeriu që është i lidhur me Allahun dhe qëndron i palëkundur në të vërtetën, mbetet i lirë, edhe kur përballet me sprova të rënda, sepse askush nuk mund t’ia robërojë shpirtin dhe vullnetin.

---

<sup>16</sup> “Biharul-Enuar, vëll. 68, f. 153.

## **Ndikimet dhe dobitë e durimit**

Në përfundim të temave të trajtuara në këtë hulumtim, është e nevojshme të flasim për dobitë dhe ndikimet e durimit. Edhe pse i kemi përmendur ato gjatë shpjegimeve të mëparshme, për të njohur më mirë ndikimet individuale dhe shoqërore të durimit, do t'i trajtojmë këtu pak më gjerësisht. Por nuk do të ndalemi te shpërblimet në Botën Tjetër, pra, te sevapet dhe shpërblimi i durimtarëve në Ditën e Gjykimit, edhe pse këto nuk mund të ndahen plotësisht nga dobitë dhe pasojat e kësaj bote.

Qëllimi ynë është të flasim për frytet që shfaqen në vetë këtë etapë të jetës, domethënë në jetën e kësaj bote, si për individin durimtar, e grupin durimtar, ashtu edhe për shoqërinë.

Nga duhet të fillojmë dhe cila është dobia më e parë? Përgjigjja mund të përmblihet në një fjali të vetme: Kjo botë dhe Bota Tjetër, qëllimet e larta njerëzore, qëllimet e këqija njerëzore, madje, çdo qëllim që dëshiron të arrijë njeriu, varet nga durimi dhe qëndrueshmëria.

Nëse kërkojmë argument për këtë të vërtetë dhe nuk na mjaftojnë përvojat e njerëzimit përgjatë gjithë historisë së tij, atëherë mjafton kjo formulë e qartë dhe vendimtare:

Arritja e çdo qëllimi kërkon përpjekje, dhe çdo përpjekje kërkon durim dhe këmbëngulje.

Çdo njeri e ka provuar këtë rregull në jetën e tij, në shumë ngjarje dhe përvoja. Nuk ka sukses, përparim a arritje pa përpjekje, Dhe, nuk ka përpjekje të vazhdueshme pa durim, qëndrueshmëri dhe vendosmëri. Prandaj, durimi është një nga shtyllat themelore të suksesit në çdo fushë të jetës. Imam Aliu (Paëja qoftë mbi të!) thotë në një nga thëniet e tij të mbushura me urtësi: *“Durimtari nuk mbetet pa fitore, edhe nëse koha zgjatet.”*<sup>17</sup> Në një hadith tjetër, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e shpreh të njëjtin kuptim me fjalë të tjera: *“Kush hipën në mjetin e durimit, arrin në fushën e fitores.”* Gjatë Luftës së Siffinit, në një hytbe, me të cilën nxiste dhe mobilizonte ushtrinë, ai tha: *“Kërkoni ndihmë përmes sinqeritetit dhe durimit, sepse pas durimit ju zbret fitorja.”*

Por, nëse durimi dhe qëndrueshmëria janë faktorë për arritjen e qëllimit dhe nëse ky është rregull i përgjithshëm dhe ligj i pandryshueshëm, atëherë pse gjatë historisë shohim individë ose grupe që nuk i arritën synimet e tyre, megjithëse qëndruan me vendosmëri, treguan qëndresë dhe sakrifikuan gjithçka që kërkonte durimi, por nuk e arritën fitoren ose nuk e shijuan ëmbëlsinë e saj?

---

<sup>17</sup> “Gurarul-Hikem ue Durerul-Kelim”.

Në historinë e hershme islame ka jo pak ngjarje që në dukje e dëshmojnë këtë:

- Ashuraja dhe martirizimi i Imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!);

- Kryengritja dhe martirizimi i Zejd ibn Aliut (Paqja qoftë mbi të!);

- Lëvizja e të penduarve (*et- teuabun*) dhe ngjarje të tjera të ngjashme;

Për t'iu përgjigjur saktë kësaj pyetjeje, e cila ngrihet shpesh nga shumë njerëz, nevojitet pak më shumë vëmendje dhe thellim. Ndoshta, ata që bëjnë këtë pyetje dhe i konsiderojnë këto ngjarje historike: Ashuranë, martirizimin e Zejdit e të tjera, sipas pamjes së jashtme, se nuk e arritën qëllimin e tyre, e si kundërshtim të këtij ligji të përgjithshëm (ligjit të durimit dhe të fitores), nuk e kanë kuptuar si duhet objektivin dhe synimin e vërtetë të asnjërës prej atyre (ngjarjeve). Përse? Sepse fitorja e vërtetë nuk matet gjithmonë me triumfin e dukshëm ushtarak ose politik, por me përmbushjen e qëllimit, për të cilin bëhet sakrifica. Kur qëllimi i një lëvizjeje përmbushet, atëherë ajo ka fituar, edhe nëse në pamje të parë duket se është mposhtur. Prandaj, për të gjykuar nëse një ngjarje ishte fitore apo humbje, duhet së pari të njohim qëllimin dhe misionin e saj të vërtetë. Vetëm atëherë mund të kuptojmë nëse ajo e arriti apo jo suksesin e saj. Për këtë arsye, fillimisht duhet t'i përgjigjemi një

pyetjeje, që ka të bëjë me qëllimin ngjarjeve historike. Nëse i japim përgjigjen e saktë kësaj pyetjeje, atëherë bëhet i qartë edhe përfundimi: Vprimtarët e këtyre lëvizjeve nuk u mundën kurrë.

Duhet të kemi parasysh se qëllimet ndryshojnë për nga afërsia ose largësia e realizimit të tyre. Disa japin rezultate të shpejta dhe të afërta, disa të tjera kanë nevojë për kohë të gjatë. Kjo është si mbjellja e një fidani dhe sigurimi i të gjitha kushteve që ai të rritet e të japë fruta. Nëse kushtet plotësohen dhe nuk ka neglizhencë në përgatitjen e tyre, e në përballimin e faktorëve negativë e shkatërrimtarë, atëherë fidani do të japë patjetër fruta. Por ka pemë që, nga natyra e tyre, kanë nevojë për më shumë se dhjetë vjet që të japin frutat e dëshiruara. Pa dyshim, qëllimi përfundimtar i kultivimit të një fidani, që ka nevojë për dhjetë vjet për t'u rritur është marrja e frutave të tij. Megjithatë, edhe vetë rritja graduale e tij është një arritje. Bujku, që është kujdesur për të pa u lodhur, gëzohet dhe është i qetë që pema po rritet dhe munda i tij nuk ka shkuar kot.

Por një vëzhgues i largët, i cili sheh pas vitit të parë mundin dhe përpjekjet e këtij bujku të durueshëm, mund të arrijë në përfundimin e gabuar: Bujku ka dështuar, sepse pema ende nuk ka fruta. Nisur nga dëshpërimi dhe mungesa e besimit, bujku mund të kundërshtojë thënien e njohur: “Pas durimit vjen fitorja”, duke u mbështetur në përvojën e tij të mangët.

Por të gjithë e dinë se një gjykim i tillë buron nga mendjengushtësia dhe mungesa e durimit. Atij kritizerit do t'i thuhej se nuk mund ta presim rezultatin e një pune dhjetëvjeçare që në vitin e parë.

Si puna e pemës, Kryengritja e Ashurasë, ajo dhe të gjitha ngjarjet që qenë vazhdim i saj dhe të ndërtuara sipas orientimit të saj, e arritën atë që synonin dhe e përmbushën qëllimin që patën përcaktuar. Secila ngjarje qe një hap i suksesshëm drejt eliminimit të pushteteve uzurpuese dhe ngritjes së shoqërisë së dëshiruar islame. Pa dyshim, sikur ata që erdhën pas tyre ta vazhdonin rrugën dhe përpjekjen, qëllimi i synuar nga të gjitha këto lëvizje dhe sakrifica do të ishte realizuar. Ndërsa të presësh që një qëllim i tillë madhor të arrihet nga përpjekja e një personi të vetëm ose e disa individëve në një periudhë të caktuar, nuk është një pritje e drejtë dhe reale.

Me shembullin e mëparshëm, mund t'i themi atij vëzhguesit që ka pak durim dhe përvojë: Ata që e kuptojnë mundin e bujkut dhe që e ndjekin nga afër punën e tij, e dinë mirë se çdo ditë që kalon dhe çdo orë që kalon është e dobishme dhe prodhimtare. Ata i shohin frutat e durimit në çdo çast, para se të vijë çasti pasues.

Dy vjet punë do të thotë që fidani është afruar dy vjet më shumë drejt pjekurisë. Po të mos ishte bërë kjo përpjekje gjatë këtyre dy viteve, frytet do të vonoheshin edhe dy vjet të tjerë. Madje mund të ndodhte që qëllimi përfundimtar të

humbiste krejt dhe të mos arrihej kurrë. A nuk është kjo e vërteta? Përveç kësaj të vërtete, ekziston edhe një e vërtetë tjetër: Nëse shfaqet një pengesë që e ndalon bujkun e kujdesshëm ta vazhdojë punën e tij, dhe nëse një bujk tjetër nuk e vazhdon atë punë, duke plotësuar detyrat e vitit të tretë dhe të katërt, atëherë fidani apo pema nuk do të piqet kurrë dhe nuk do të japë frutin e saj.

Pa dyshim, fruti i durimit gjatë dy vjetëve të parë është arritur. Ashtu siç nuk është e mundur të shkulet një pemë me rrënjë të thella apo të hiqet një shkëmb i madh pa mjetet e nevojshme dhe pa një dorë të fortë, po ashtu edhe pa durim nuk mund të arrihet asnjë rezultat. Nëse një dorë e fortë dhe e durueshme i kryen hapat e parë të nevojshëm, por më pas ndalet për shkak të ndonjë pengese, dhe duar të tjera e vazhdojnë punën, atëherë rezultati i synuar afrohet gjithnjë e më shumë.

Kështu ishte edhe me Zejd ibn Aliun (Apaqja qogtë mbi të!). Edhe pse u shfaqën shenja të fitores, ai vetë nuk e pa triumfin përfundimtar. Megjithatë, ai realizoi atë që pritej nga kryengritja e tij. Ngritja dhe martirizimi i tij që një goditje e fortë mbi shkëmbin e pushtetit omejad. Ky shkëmb nuk mund të thyhej me një goditje të vetme. Ai kishte nevojë për goditje të njëpasnjëshme. Dhe kur pas asaj goditjeje erdhën goditje të tjera, ai shkëmb i zi që rëndonte mbi gjoksin e ymetit islam u shemb.

Nuk ka dyshim se, po të mos kishte qenë goditja e parë, goditjet pasuese nuk do ta kishin arritur qëllimin e tyre, madje, ndoshta, as nuk do të kishin ndodhur fare. Hadithet na tregojnë se martirizimi i imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!) u bë shkak për rrëzimin e rrymës sufjanite (*emevite*), ndërsa martirizimi i Zejd ibn Aliut (Paqja qoftë mbi të!) u bë shkak për rënien e sundimit *meruanit*.

## **Ndikimet individuale dhe psikologjike të durimit**

Përveç ndikimeve shoqërore, të cilat përfshijnë fitoren dhe arritjen e qëllimit, durimi ka edhe ndikime të tjera pozitive dhe shumë të rëndësishme që pasqyrohen në shpirtin dhe psikologjinë e durimtarit. Duke u njohur me këto ndikime të mrekullueshme, kuptohen më e lehtë shumë nga sakrificat historike, veçanërisht, sakrificat madhështore të heronjve të Kerbelasë.

Ndikimi i parë pozitiv i durimit: Durimtari bëhet më i fortë, më i vendosur dhe më i palëkundur përballë humbjes dhe thyerjes shpirtërore. Kjo ngjan me ushtrimet e vështira fizike, të cilat sa më shumë përsëriten, aq më shumë e forcon trupin.

Ky durim vlen për të gjitha punët dhe aspektet e jetës, qofshin ato të kësaj bote apo të Botës Tjetër. Durimi e forcon vullnetin, e kalit karakterin dhe e bën njeriun më të aftë për t'u përballur me sfidat dhe vështirësitë e jetës. Të gjitha humbjet që ndodhin gjatë përballjeve shoqërore, fetare dhe praktike burojnë nga humbja shpirtërore dhe pranimi i thyerjes së brendshme. Një shpirt i mposhtur e ndien humbjen shumëfish më rëndë sesa humbjen që mund të vijë

nga mungesa e pajisjeve ushtarake ose nga mangësitë në strategji dhe manovra.

Ushtari që i kthen shpinën armikut dhe ikën nga fusha e betejës, në të vërtetë është mposhtur psikologjikisht përpara se të mposhtet fizikisht ose materialisht. Ndërsa, nëse nuk është mposhtur shpirtërisht dhe moralisht, është pothuajse e pamundur që ai të largohet me frikë nga fusha e luftës. Prandaj, veçoria e parë e durimit në aspektin individual është krijimi i qëndresës shpirtërore të durimtari.

Kur përballen me fatkeqësi në jetën e tyre, si humbje materiale, sëmundje, vuajtje a vdekje e të dashurve, njerëzit shpesh nuk tregojnë durim, por dorëzohen dhe dëshpërohen. Po kështu, kur hasin pengesa dhe vështirësi të shumta, tërhiqen dhe heqin dorë. Kurse, ai që tregon durim dhe përdor në çdo sprovë armën e fortë të durimit, fiton forcë shtesë dhe aftësi më të madhe për t'u përballur me problemet e jetës. Çdo sprovë e përballuar me durim e bën atë më të fortë, më të qëndrueshëm dhe më të aftë për të përballuar sfida edhe më të mëdha në të ardhmen.

Njeriun pa durim mund ta krahasojmë me një ushtar që hyn në fushën e betejës pa mburojë mbrojtëse. Ky ushtar rrëzohet që me goditjen e parë që i jep armiku. Ndërsa njeriu i durueshëm i ngjan ushtarit që mban mburojë që i mbron tërë trupin. Prandaj, mposhtja e këtij ushtari është shumë më e vështirë sesa e të parit.

Ai që nuk mposhtet në betejën e jetës është ai që është përgatitur paraprakisht për të dhe që ka veshur mburojën e vërtetë të durimit, e cila nuk pranon humbjen. Ky njeri nuk dobësohet lehtë, nuk pranon poshtërimin dhe nuk tronditet nga përballja me vështirësitë dhe vuajtjet që duhen pritur gjatë rrugës drejt përsosurisë dhe lumturisë. Zemra e tij nuk ligështohet dhe këmbët e tij nuk lëkunden.

Këtë shpjegim dhe këtë frymëzim të madh islam mund ta kuptojmë më thellë me atë që na ka ardhur nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), kur thotë: *“Ka dështuar ai, që nuk e ka përgatitur durimin për çdo sprovë.”*

Në këtë mënyrë shpjegohet edhe qëndrueshmëria dhe vendosmëria e burrave të mëdhenj që kanë bërë historinë. Në krye të tyre janë profetët dhe njerëzit e Zotit, të cilët që nga fillimi përballuan çdolloj torture dhe forme persekutimi nga tiranët. Dhe thirrja e tyre u përhap në të gjitha anët dhe la gjurmë të thella.

Përhapja e kësaj thirrjeje nuk u arrit veçse përmes durimit që ata kishin përgatitur për t’u përballur me pengesat dhe vështirësitë. Ky durim krijoi tek ata një shpirt të pamposhtur dhe i shndërroi në njerëz me një forcë dhe qëndrueshmëri të jashtëzakonshme. Shpesh, armiqtë e tyre kishin mundësi dhe mjete shumë më të mëdha, por u lodhën dhe u dorëzuan, sepse besimtarët dhe njerëzit e së Vërtetës nuk u dobësuan dhe nuk u tërhoqën.

El-Muteuakil El-Abasij, perandori tiran, thoshte: 'Më ka lodhur djali i Ridasë.' Si arriti vallë imam Hadi (Paqja qoftë mbi të!), i cili shumicën e jetës së tij e kaloi nën presionet dhe vuajtjet që i ushtronte Muteuakili, ta lodhte këtë sundimtar të fuqishëm dhe shtypës?

Kur njëri prej palëve ndërluftuese është i dobët për sa i përket mundësive materiale dhe kalon pjesën më të madhe të ditëve të tij në burg, larg sigurisë dhe rehatisë, por nuk shqetësohet, nuk lodhet përballë të gjitha presioneve e vështirësive dhe vazhdon të ecë përpara, pavarësisht të gjitha pengesave dhe vështirësive që gjenden në rrugën e tij, atëherë është e natyrshme që ta bëjë kundërshtarin e tij të dorëzohet dhe ta zhgënjejë atë, edhe nëse ky kundërshtar gëzon të gjitha mundësitë materiale dhe aftësitë e nevojshme. Kjo ndodh ngaqë kundërshtari nuk e zotëron shpirtin e besimit në përpjekje dhe në qëllim. Kjo është veçoria e mahnitshme e durimit-ai e bën njeriun të mos e pranojë kurrë humbjen.

Njeriu, në shumicën e rasteve, nuk është në gjendje ta vlerësojë veten para se të sprovohet dhe të vihet në provë. Për këtë arsye, ai nuk di shumë për fuqitë e fshehura brenda tij. Për shembull, nëse një njeri është natyrshëm i fortë, por nuk bën ushtrime dhe nuk kryen ndonjë aktivitet që ta provojë forcën e tij (ngritja e një peshe të rëndë me të cilën mund të matë fuqinë e tij), është e natyrshme që ky të mos i njohë forcën dhe aftësitë e tij fizike. Ai e zbulon fuqinë e tij

vetëm atëherë kur i kërkohet të kryejë një punë që kërkon forcë.

Këtu kuptojmë ndikimin e dytë të durimit: ai e bën njeriun e durueshëm dhe të qëndrueshëm, të njihet me masën e forcës së tij dhe me aftësitë pozitive të fshehura brenda tij, të cilat nuk shfaqen në jetën e zakonshme dhe të qetë. Këtë e kuptojnë shumë mirë të gjithë ata që kanë shijuar vështirësitë dhe janë përballur me presione e sprova gjatë rrugëtimit drejt qëllimeve të tyre, duke u mbështetur në bindjet dhe besimet e tyre të larta.

Njerëz të tillë shohin te vetja e tyre fitore dhe arritje të brendshme gjatë përballjes me rreziqe dhe vështirësi, të cilat një njeri i zakonshëm mund t'i konsiderojë të papërballueshme. Prandaj, ata fitojnë fuqi të mëdha dhe të mahnitshme. Ata kanë zbuluar brenda vetes diçka që më parë nuk e dinin se e kishin. Prandaj, durimi e ndihmon njeriun të njohë më mirë veten dhe të zbulojë ato cilësi dhe aftësi pozitive që Allahu i ka vendosur brenda tij.

## Mbështetje më e madhe tek Allahu

Veçoria e tretë formuese e durimit është se njeriu, kur gjendet i vetëm në çfarëdo etape të jetës, afrohet më shumë me Allahun dhe mbështetet më shumë tek Ai.

Disa mendojnë se mbështetja tek Allahu (*et-teuekkul*) bie ndesh me vetëbesimin dhe mbështetjen te vetja. Ata mendojnë se ai që dëshiron të mbështetet tek Allahu, nuk duhet të mbështetet te vetja ose të ketë besim te aftësitë e tij. Prandaj, kur u thuhet: “Mbështetuni tek Allahu”, ata përgjigjen: “Pse doni t’ua hiqni njerëzve frymën e vetëbesimit dhe të mbështetjes te vetja?” Sikur ai që i fton njerëzit të mbështeten tek Allahu, po u thoshka njëkohësisht: “Mos u mbështetni te vetja!”

Por për besimtarin ka një lidhje të ngushtë mes *teuekkulit* tek Allahu dhe mbështetjes te vetja. Madje, ai e konsideron vetëbesimin si një nga dimensionet e durimit dhe si një mjet që e çon njeriun drejt mbështetjes tek Allahu. Ndërsa ai që nuk ka durim, gjatë përballjes me sprovat dhe vështirësitë e zgjedhura me vetëdije, do të tronditet dhe do të humbasë qëndrueshmërinë për shkak të mungesës së besimit në vetvete. Si pasojë, ai do ta harrojë Allahun dhe do të largohet edhe prej Tij.

Kur njeriu përballet me vështirësitë dhe sprovat e kohës, kur krizat e rrethojnë dhe vështirësitë e rëndojnë, por ai nuk dëshpërohet dhe nuk ankohet, atëherë, para tij hapen dritaret e një lidhjeje më të thellë me Allahun. Atij i bëhet më e lehtë që ta lidhë zemrën dhe shpirtin e tij me dritën e pranisë së Allahut. Ndërsa shfaqja e pafuqisë dhe dobësisë e largon njeriun nga Allahu i Madhëruar dhe e shkëput edhe nga vetvetja.

Kjo është një nga ato të vërteta që përvoja dhe vëzhgimi i drejtpërdrejtë i kanë vërtetuar më së miri. Ata, që në situata të tilla kanë përdorur armën e durimit, e pranojnë dhe e dëshmojnë këtë realitet pa asnjë dyshim.

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَتَبِّثْ أَفْئَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

**“Zoti ynë! Na dhuro durim të madh, na i forco këmbët tona dhe na jep fitore kundër popullit jobesimtar.”<sup>18</sup>**

*Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.*

---

<sup>18</sup> Sure “El-Bekare”, ajeti 250

## **Përmbajtja**

|                                                                              |    |
|------------------------------------------------------------------------------|----|
| Parathënie.....                                                              | 5  |
| Koncepti i durimit.....                                                      | 12 |
| Koncepti popullor për durimir.....                                           | 12 |
| Një vështrim i përgjithshëm për burimet që trajtojnë durimin .....           | 14 |
| Durimi kur kryejmë detyrat fetare .....                                      | 36 |
| Durimi në bindjen para Allahut në jetën e Imamëve (Paqja qoftë mbi ta!)..... | 43 |
| Një vështrim në Kur'an.....                                                  | 45 |
| Durimi para mëkatit .....                                                    | 47 |
| Rëndësia e durimit para mëkatit .....                                        | 51 |
| Një shembull i durimit para mëkatit.....                                     | 53 |
| Shembuj të tjerë.....                                                        | 58 |
| Durimi para sprovave të zgjedhura me vetëdije.....                           | 71 |
| Ndikimet dhe dobitë e durimit .....                                          | 81 |
| Ndikimet individuale dhe psikologjike të durimit .....                       | 88 |
| Mbështetje më e madhe tek Allahu .....                                       | 93 |
| Përmbajtja.....                                                              | 95 |

إسم الكتاب: بحث حول الصبر

المؤلف: الإمام الشهيد السيد علي الخامنئي (قدسه)

المترجم: الحاج الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي: بيردا كولا

التصحيح اللغوي: إسماء مريا

الإخراج النهائي: صريه فزا

الغلاف: صريه فزا

الناشر: جمعية النسيم

تيرانا- البانيا- 2026